



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
Drejtoria e Pergjithshme e Politikave
Makroekonomike dhe Fiskale

SFIDAT E POLITIKËS FISKALE
NË TË ARDHMEN

Tiranë, 14 Maj 2008

Tabela e përmbajtjes

1. Vlerësimet dhe Zhvillimet Makroekonomike dhe Fiskale.....	2
<i>1.1. Zhvillimet makroekonomike: historia dhe faktet.....</i>	<i>2</i>
1.2. Politika Fiskale.....	6
1.2.1. Politika e taksave dhe zhvillimet fiskale.....	6
1.2.1.1. Struktura e taksave.....	8
1.2.2. Politika e Shpenzimeve.....	11
1.2.3. Menaxhimi i Borxhit.....	12
2. Politika makroekonomike dhe përqasja fiskale në të ardhmen.....	13
2.1. Parashikimet Makroekonomike.....	14
2.2. Politika Fiskale.....	16
2.2.1. Politika e taksave	16
2.2.2. Administrimi i Taksave.....	17
2.2.3. Decentralizimi Fiskal	19
2.2.4. Parashikimi i të ardhurave.....	21
2.2.5. Politika e shpenzimeve	22
2.2.6. Menaxhimi i Borxhit.....	23
3. Konkluzionet.....	24
4. ANEKS	26



1. Vlerësimet dhe Zhvillimet Makroekonomike dhe Fiskale

1.1. Zhvillimet makroekonomike: historia dhe faktet

Në fillim të viteve 90 Shqipëria ndërmori rrugën e vështirë të hapjes së ekonomisë së saj nga një ekonomi e mbyllur në një ekonomi të tregut të lirë. Gjatë kësaj kohe Shqipëria filloi t'i nënshtronte një regjimi ri-strukturimi makro-ekonomik në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankën Botërore (BB). Nevoja për reforma ishte shumë e madhe duke përfshirë të gjithë sektorët e ekonomisë.

Procesi i tranzicionit dhe kalimi i ekonomisë tonë nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë është shoqëruar jo vetëm me transformimin e mekanizmave dhe infrastrukturës të funksionimit të tregjeve, por mbi të gjitha me nevojën e zhvillimit dhe krijimit të instrumentave dhe hapësirave të reja ligjore, institucionale, ekonomike dhe sociale me qëllim rritjen e efikasitetit alokues dhe përdorues të resurseve publike dhe private.

Gjithashtu është synuar të arrihet një rishpërndarje në mënyrën sa më eficiente e PBB midis grupeve të ndryshme sociale dhe janë ngritur mekanizma të mbrojtjes sociale në funksion të rritjes së mirëqenies, uljes së pabarazisë, si dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.



Vlerësimet dhe zhvillimet ekonomike, konfirmojnë që ekonomia shqiptare gjatë dekadës së fundit është karakterizuar nga një rritje ekonomike e lartë dhe e qëndrueshme (Tabela 1). Zhvillimet ekonomike këtij 10 vjeçari reflektojnë proceset transformuese dhe ristrukturuese të ekonomisë, e shoqëruar me “goditje pozitive dhe negative” në vite të caktuara, drejt një ekonomie të bazuar në mekanizmat e tregut dhe iniciativës së lirë. Gjithashtu prirja e rritjes ekonomike në vite evidenton qartë prezencën e hapësirave potenciale të mëdha për mbështetjen e një norme rritje të lartë e persistente, si në kohë, ashtu edhe në aspektin e shfrytëzimit të burimeve prodhuese.




Gjatë dekadës së fundit ritmi i rritjes ekonomike të Shqipërisë ka qënë mesatarisht nga më të lartët ndër të gjithë vendet e rajonit. Kjo është shoqëruar me një normë inflacioni relativisht të ulët. Produkti

i Brendshëm Bruto (PBB) gjatë kësaj periudhe është rritur mesatarisht me 6 për qind në vit duke bërë që PBB/banorë nga 1190 USD që ishte në vitin 2000 të arrijë në rreth 3,400 USD në 2007 duke pësuar gati një trefishim, gjë e cila reflekton qartë rritjen e konsiderueshme të standartit të jetesës. Norma e inflacionit gjatë periudhës 2000 - 2007 ka qënë mesatarisht rreth nivelit 3 përqind në vit, normë kjo e përcaktuar si më optimalja për ekonominë tonë.

Gjatë këtyre viteve ekonomia shqiptare, e udhëhequr kryesisht nga mekanizmat e tregut të lirë, ka pësuar ndryshime strukturore të konsiderueshme. Ndër ndryshimet strukturore më evidente gjatë 10 viteteve të fundit do veconim zvogëlimin gradual të sektorit të bujqësisë nga rreth 35 përqind të PBB në rreth 18 përqind të tij e shoqëruar kjo me rritjen e sektorit të ndërtimit nga 5 për qind në rreth 13 përqind, si dhe rritjen e shërbimeve nga 47 në rreth 52 përqind të PBB. Kontributi i industrisë

në PBB ka mbetur pak a shumë në të njëjtat nivele, mesatarisht rreth 8 përqind e PBB. Në rritjen ekonomike të këtyre 10 viteve të fundit, e vlerësuar mesatarisht me rreth 6 përqind në vit, bujqësia dhe industria kanë dhënë një kontribut mesatar prej rreth 0.9 pikë përqindje secila, ndërtimi rreth 1.4 pikë përqindje dhe shërbimet kanë dhënë një kontribut prej rreth 3 pikë përqindje.

Zhvillimet përgjithësisht pozitive në tregjet e të të mirave e shërbimeve reflektohen dhe në atë të punës. Punësismi është rritur e norma e papunësisë përgjatë viteve të fundit ka rënë gradualisht me një ritëm mesatar prej rreth 0.7 pikë përqindje në vit duke arritur në 13.2 përqind në vitin 2007 nga 16.8 për qind që ajo shënonte në vitin 2000. Pagat gjithashtu kanë qënë në të njëjtën linjë me ecurinë e inflacionit dhe të papunësisë. Pagat mesatare të sektorit privat (përfshirë bujqësinë) kanë patur me një trend mester rritës prej rreth 9 përqind në vit. E njëjta ecuri paraitet edhe në pagat mesatare e minimale të sektorit shtetëror.




për qind duke arritur në rreth 29 përqind të PBB në vitin 2007 nga rreth 4.2 përqind që ishte në vitin 2000. Për t'u evidentuar është fakti që gjatë tre viteve të fundit ritmi i rritjes së kredisë për ekonominë ka shënuar kulmin e tij. Gjatë këtyre viteve të fundit kredia është rritur mesatarisht rreth 60 për qind në vit. Por megjithë zgjerimin e madh të kredisë e të sektorit financiar në

përgjithësi, sistemi financiar konsiderohet mjaft i qëndrueshëm e solvent. Sistemi financiar akoma karakterizohet nga një likuiditet i lartë. Kreditë e “këqija” kanë qënë në nivele mjaft të ulta e të menaxhueshme si në raport me PBB (mesatarisht në nivelin 1.1 përqind të PBB), ashtu dhe në raport me totalin e kredisë ku duket qartë një rënie e këtij treguesi (nga rreth 46 përqind në vitin 2000 në rreth 8 përqind e totalit të kredive në vitin 2007).

Norma e inflacionit gjatë kësaj dekade është mbajtur në nivele relativisht të ulta e brenda intervalit objektiv të përcaktuar. Monedha vendase është karakterizuar nga një kurs këmbimi përgjithësisht i qëndrueshëm kundrejt monedhave të huaja ku megjithatë duhet evidentuar , një mbiçmimi i ndjeshëm i Lekun daj dollarit amerikan gjatë dy viteve të fundit, gjë e cila reflekton kryesisht ecurinë e këtij të fundit në bursat ndërkombëtare.

Rritja ekonomike e lartë është karakterizuar gjithashtu nga zhvillime të kënaqshme edhe në sektorin e jashtëm. Llogaria korrente edhe pse me një bilanc negativ përgjatë këtyre viteve, karakteristikë kjo e ekonomive në zhvillim, deficiti i saj ka qënë relativisht i ulët në krahasim me pjesën më të madhe të vendeve të rajonit. Eksportet e mallrave kanë patur një rritje graduale gjë e cila ka nxjerrë në pah avantazhet krahasuese të Shqipërisë. Eksportet janë rritur mesatarisht nga viti në vit me rreth 2 pikë përqindje më tepër se sa importet. Produktet të cilat kanë zënë peshën më të madhe të eksporteve gjatë kësaj dekade dhe të cilat janë kthyer tashmë në produkte tradicionale të eksportit, janë tekstilet dhe veshjet e këmbëve. Secila prej këtyre dy kategorish ka përbërë mesatarisht rreth 30 përqind të eksporteve totale të Shqipërisë. Metalet, mineralet dhe një sërë produktesh ushqimore kanë patur gjithashtu një peshë të konsiderueshme në eksportet e vendit.



Sa i takon shportës së produkteve të importuar nga ekonomia shqiptare ajo përbëhet nga një numër i konsiderueshëm grup-mallrash, të cilat variojnë nga makineritë, mjetet e transportit, paisjet elektronike, një larmi materialesh të përdorura në procesin e prodhimit, lëndët energjetike e energjia elektrike, e deri tek veshjet e një sërë produktesh ushqimore. Gjithsesi, vlen për t’u evidentuar fakti që grup-mallrat të cilat përbëjnë peshën kryesore të importeve janë ato të cilat kanë të bëjnë me natyrën *sipërmarrëse e biznes- zhvilluese të ekonomisë tonë*, sic janë makineritë e mjetet e transportit e paisjet elektrike, të cilat gjatë viteve kanë zënë mesatarisht rreth 22 përqind të importeve, si dhe metalet, materialet e konsumit të ndërmjetëm e produktet energjetike përfshirë energjinë elektrike, të cilat kanë përbërë mesatarisht rreth 42 përqind të totalit të importeve.


Megjithatë, Shqipëria mbetet ende një vend importues neto me importe që i kalojnë disa herë eksportet. Një pjesë e konsiderueshme e këtij deficiti tregtar (mesatarisht gjysma e tij) është mbuluar tashmë tradicionalisht nga të ardhurat e një numri mjaft të lartë emigrandësh shqiptarë që ndodhen jashtë vendit, kryesisht në dy vendet fqinje Itali e Greqi. Remitancat nga viti 2000 deri në vitin 2007 vlerësohen të jenë rritur mesatarisht me rreth 16 përqind në vit. Të shprehura si raport ndaj PBB, gjatë kësaj periudhë remitancat kanë qënë mesatarisht rreth 14 përqind e tij.

Tranferrat vazhdojnë të mbeten një burim i rëndësishëm i financimit të llogarisë korriente, duke arritur në 15 % të PBB-së, megjithsë pesha e tyre ka ardhur duke u ulur.


Një tjetër zë në marrdhëniet ekonomike të Shqipërisë me vendet e huaja, i cili në përgjithësi ka patur një trend rritës duke dëshmuar dhe njëherë për konsolidimin e zhvillimin e vazhdueshëm jo vetëm ekonomik, por dhe atë social e politik të vendit, janë investimet e huaja direkte. Gjatë kësaj dekade këto investime janë rritur mesatarisht me rreth 53 përqind në vit duke përbërë mesatarisht rreth 4.1 përqind të PBB. Vetëm gjatë vitit 2007 investimet e huaja direkte u rritën me rreth 80 përqind duke përbërë rreth 6 përqind të PBB të këtij viti.

Këto dhe të tjera zhvillime në sektorin e jashtëm kanë cuar në rritjen e vazhdueshme e të konsiderueshme të rezervave valutore në dispozicion të autoritetit monetar. Rezervat valutore të Bankës së Shqipërisë janë rritur mesatarisht me rreth 26 përqind në vit. Në fund të vitit 2007 stoku i mjeteve valutore neto të bankës qendrore ishte i mjaftueshëm për të mbuluar rreth 4.2 muaj import mallrash e shërbimesh tregues i cili e vendos ekonominë vendase në një pozicion relativisht të kontrollueshëm kundrejt ekspozimit dhe varësisë së ekonomive të huaja.

Stabiliteti makroekonomik është mbështetur gjithashtu edhe nga një konsolidim i vazhdueshëm fiskal. Bilanci fiskal është përmirësuar duke u mbështetur në kombinimin: rritje e qëndrueshme e të ardhurave dhe ulje të shpenzimeve publike të cilat shoqërohen me një përmirësim cilësor strukturor/përbërje dhe të eficiencës në përdorimin. Kështu, të ardhurat totale në raport me Produktit e Brendshëm Bruto (PBB) janë rritur nga viti në vit, ndërsa deficitet buxhetor ka një trend të qartë në rënie, nga rreth 8 % në vitin 2000 në 3.2 % në 2007, dhe në nivele më të menaxhueshme.



Investimet publike në raport me PBB janë rritur gjatë viteve të fundit. Gjithashtu duhet theksuar që këto investime në vitet e fundit kanë qënë në një masë të konsiderueshme më të larta se sa deficitet i përgjithshëm gjë e cila do të thotë që një pjesë e mirë e tyre janë financuar prej të ardhurave të shtetit dhe jo me borxh.



Financimin e deficitit buxhetor është mbështetur kryesisht nga burimet e brendshme, si huamarja e brendshme dhe të ardhurat nga privatizimi, por edhe financimi i huaj ka pasur një rol të rëndësishëm. Diferenca ndërmjet financimit të brendshëm dhe atij të huaj ka ardhur duke u ngushtuar, c'ka reflekton nga njëra anë rritjen e kapacitetit huamarrës të ekonomisë shqiptare si dhe përmbushjen e detyrimeve, e nga ana tjetër demonstroi rritjen e kredibilitetit të qeverisë shqiptare e të ekonomisë në përgjithësi tek institucionet dhe organizmat e ndryshme financiare ndërkombëtare.

Gjithashtu, marrja e vlerësimit të “Credit Rating” vitin e kaluar nga Moody’s Investors & Service, me B1, do të ndikojë në tërheqjen e investimeve të huaja. Gjithashtu, sipas “Heritage Foundation”, reformat e ndërmarra nga qeveria kanë pasur si rezultat që Shqipëria të ketë një liri ekonomike më të madhe se shumë vende të rajonit dhe të BE, dhe të deklarohej si vendi me liri fiskale më të lartë në Europë. Këto indikatorë tregojnë që reformat kanë përmirësuar klimën e biznesit dhe ridimensionuar liritë e tregut.

1.2. Politika Fiskale

Zhvillimet fiskale në Shqipëri gjatë këtyre viteve janë karakterizuar nga përmbushja e parametrave fiskale të rënë dakord me FMN-në.

1.2.1. Politika e taksave dhe zhvillimet fiskale

Sistemi shqiptar i taksave është shumë i ri, dhe ashtu si vendet e tjera të europës lindore dhe qendrore, pati avantazhin e krijimit “nga fillimi”, duke u bazuar në eksperiencën e vendeve të zhvilluara perëndimore. Megjithatë, për nga vete specifikat dhe vecoritë e strukturës ekonomike dhe sociale të vendit, politika e taksave dhe rregullat për administrimin e tyre kanë qenë në ndryshim të vazhdueshëm. Ndër këto specifika mund të veçohen: kultura tepër e ulët e pagimit të taksave, shkalla e lartë e informalitetit në ekonomi, si edhe pesha e rendësishme e bujqesise në strukturen e PBB dhe në punësim.

Gjatë viteve të tranzicionit ekonomik, shpesh mosperputhja e politikës së taksave me këto specifika si dhe mangësitë në administrim kanë krijuar baza të ngushta tatimore dhe sisteme taksimi deformuese, komplekse dhe të vështira për t’u kuptuar dhe administruar. Ky fakt ka ndikuar gjithashtu në deformimin e vendimeve të biznesit për investime dhe në realizimin me vështirësi të aktivitetit.

Në këtë kontekst, reformimi i sistemit të taksave ka qenë i vazhdueshëm dhe veçanërisht intensiv në vitet e fundit, duke konsideruar si objektiv kryesor të politikës së taksave, *balancimin e objektivit fiskal, mbledhja e të ardhurave për financimin e buxhetit të shtetit, me përdorimin e taksave si një instrument të politikës ekonomike, për të nxitur investimet, punësimin dhe formalizimin e ekonomisë.*

Në kuadër të ndryshimeve në politiken fiskale, viti 2007 mund të konsiderohet viti i reformës në drejtim të krijimit të një sistemi tatimor me ngarkesa fiskale më të ultat krahasuar me vendet e rajonit.

Synimet bazë të politikës fiskale përgjatë vitit 2007 ishte zhvillimi i një sistemi taksash që mbështet formulimin e politikave fiskale *te drejta dhe nxitese për zhvillimin ekonomik dhe të biznesit.* Politikat e taksave dhe niveli i tyre kanë qenë në funksion të strategjive ekonomike dhe sociale të Qeverisë. Paralelisht me këtë qëllim *shpërndarja e barres së taksave në mënyrë me të*

barabarte dhe me pak deformuese, ka qënë element dhe tipar tjetër i rëndësishëm i kësaj reforme fiskale.

Reformat më të rëndësishme të politikës fiskale u miratuan ne paketën fiskale në korrik 2007, dhe mund të përmbliidhen si mëposhtë:

A) Aplikimi i taksës së sheshtë

- *Aplikim te sistemit taksës së sheshtë, prej 10% nga 1 korrik 2007, per tatimin mbi te ardhurat personale, duke eliminuar shkallet tatimore progresive, dhe duke mbajtur nje nivel pragu perjashtues prej 10.000 leke per pagat deri ne 30.000 leke.*
- *Pergjysmim i normes se tatimit te fitimit, nga 20% ne 10%, nga 1 Janari 2008.*
- *Ndryshim i akcizës për disa mallra, duke i përafuar me nivelin e akcizave të rajonit.*
- *Nje rritje ne nivelin e taksave nacionale, duke konsideruar nje rritje te taksës se importit te automjeteve te perdoruara, reduktim te taksës se diteqendrimit te automjeteve te huaja, taksës konsulllore si dhe atyre portuale.*
- *Rritje ne nivelin e taksave vendore, respektivisht taksa e pasurise per ndertesat te cilat ndodhen ne pronesi apo perdorim brenda teritorreve te fshatrave turistike.*
- *Reduktim ne taksat doganore, si pasoje e berjes zero te taksës doganore per automjetet .*

Gjithashtu, lidhur me taksimin e biznesit te vogel, gjate 2007 qeveria ndermori dhe nje hap tjetër ne drejtim te rritjes se formalizimit dhe deklarimit te aktivitetit te bizneseve (te medha dhe te vogla), duke perfshire te ardhurat nga aktiviteti i bizneseve te vogla ne tatimin mbi te ardhurat personale, permes taksimit me 10 perqind te diferences midis te ardhurave dhe shpenzimeve, me detyrimin e deklarimit dhe dokumentimit te ketij aktiviteti per efekt te pageses se taksës.

B) Eleminimi i përjashtimeve

Aplikimit të taksës së sheshtë, u shoqërua me një "paketë" të dytë e cila konsistonte në eliminimin e të gjitha përjashtimeve dhe lehtësirave që ishin akorduar më parë si në tatimin mbi fitim ashtu edhe për TVSH. Politika e shfuqizimit dhe minimizimit te perjashtimeve nga taksat, eshte nje politike, e cila eshte ndjekur nga pothuajse te gjitha vendet te cilat kane aplikuar sistemin taksa e sheshte. Heqja e këtyre përjashtimeve të dhëna me ligjet fiskale apo ligje te tjera te vecanta do te kene impaktin e vet pozitiv ne buxhetin e shtetit, duke siguruar te ardhura shtese jo vetem nga eleminimi i tyre, por gjithashtu edhe nga permiresimet ne administrimin e burimeve te tjera, te cilat linin shteg per abuzime.



C) Politka lehtësuese fiskale

Gjithashtu, në vëmendje ka qënë akordimi i lehtësive fiskale për dy sektorë të rëndësishëm: (i) enegjinë dhe (ii) bujqësinë. Në këtë kuadër, subjektet të cilët ndërtojnë burime të prodhimit të energjisë elektrike, me fuqi të instaluar jo më pak se 5MË për burim, përfitojnë rimbursimin e akcizës së paguar, të lëndës djegëse të përdorur. Gjithashtu, janë shfrytëzuar disa elementë të mekanizmit të tatimit mbi vlerën e shtuar, me qëllim të ndikimit të tyre në një fushë sic është ajo e sistemit agrar. Nga 1 janar 2008, fermerët përfitojnë një kompensim prej 6% për të mbuluar pjesërisht një pjesë të TVSH-së së paguar më parë prej tyre e përfshirë në çmimin e blerjes së

mallrave e shërbimeve, që atyre u janë furnizuar për nevoja të veprimtarisë së tyre ekonomike.

1.2.1.1. Struktura e taksave

Përformancës e të ardhurave është analizuar duke grupuar në 3 grupe kryesore taksa indirekte, direkte dhe kontributi i sigurimeve shoqërore¹. Taksat indirekte zënë peshën kryesore të të ardhurave (tabela 2). Përforma pozitive e të ardhurave në vitet e fundit, reflektojnë përmirësimin në klimën e biznesit dhe në politikat për zhvillimin e sektorit privat. Megjithatë, të ardhurat tatimore në raport me PBB-në janë më të ulta se sa vendet e rajonit dhe të europës (tabela 3,). Kjo diferencë vjen kryesisht jo vetëm nga struktura e PBB-së, ku sektori bujqësor ka një peshe të konsiderueshme dhe është një sektor gjërisht jo i monetizuar dhe informal, dhe niveli i ulët i taksave (tatim fitimi, akcizë, taksa e punës) në krahasim me vendet e tjera, por gjithashtu edhe nga përforma e ulët në administrim.



A) Taksat indirekte

Taksat indirekte përbejnë burimin kryesor të të ardhurave buxhetor, duke arritur në rreth 50 % të totalit. Të ardhurat nga taksat indirekte në raport me PBB-në kanë një tendencë në rritje, megjithëse janë më të ulta në krahasim me vendet e tjera. Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), i cili zëvendësoi tatimin mbi xhiron në 1996, dhe akcizat janë dy kategoritë kryesore të taksave indirekte, si edhe kontribuesit kryesor të të ardhurave totale, duke arritur në 46 % në vitin 2007. TVSH-ja është kontribuesi më i madh i të ardhurave totale, mesatarisht me rreth 31 %, me një trend rritës, duke arritur në rreth 35 % në vitin 2007, si rezultat edhe i rritjes së investimeve në këtë vit.

Ndryshimet me të rëndësishme që ka pësuar TVSH-ja në Shqipëri lidhen me: administrimin e rimbursimit të TVSH; shfuqizimin e disa përjashtimeve nga kjo takse, për të reduktuar në minimum shfrytëzimin e hapësirave ligjore për evazion; përdorimin e disa mekanizmave të funksionimit të kësaj takse për të mbështetur zhvillimin e disa sektoreve të rëndësishme të ekonomisë shqiptare, siç janë bujqësia dhe energjika.

¹ Për efekt analize, në taksat direkte janë përfshirë, tatim mbi fitimi, tatim mbi të ardhurat personale, dhe tatim mbi biznesin e vogël, taksat lokale dhe taksa nacionale; në taksat indirekte janë përfshirë TVSH, Akciza, taksa doganore.

Kontributi i te ardhurave nga akciza ka qene në rritje të vazhdueshme, nga 7 % në vitin 2000, në 11 % të të ardhurave totale në 2007, duke qenë kështu një nga taksat kryesore për nga pesha në të ardhurat buxhetore. Ndryshimet e politikave mbi kete takse kane synuar permiresimin e administrimit te saj (magazinat tatimore per mallrat e akcizes, regjimi i pezullimit tatimor, sistemi i garancive, dhe te tjere elemente te funksionimit te takses), dhe shfrytezimin e potencialit të të ardhurave të kësaj takse. Të ardhurat nga akciza përbëjnë një burim financimi jo deformues per kompensimin e humbjeve nga te ardhurat nga taksa doganore dhe ne pergjithesi per rritjen e te ardhurave tatimore.

Te ardhurat nga taksa doganore kanë ardhur në rënie, dhe jane ndikuar dhe do te vazhdojne te ndikohen nga efektet e politikës tregtare te vendit, dhe me konkretisht nga ulja e vazhdueshme e tarifave doganore, që është në koherencë të plotë me liberalizimin tregtar dhe marrëveshjen e tregtisë së lirë, si edhe me marreveshjet me vende të ndryshme, si Turquia apo vende të europës lindore. Në terma mesatar, tarifat doganore kanë ardhur vazhdimisht, nga 10 % në vitin 2000 në rreth 3 % në vitin 2008.

B) Taksat direkte

Tatim fitimi, tatimi mbi të ardhurat personale janë kontribuesit kryesor në grupin e taksave direkte, duke zënë rreth 14 % të ta ardhurave totale në vitin 2007. Në krahasim me vendet e tjera, të ardhurat nga taksat mbi të ardhurat (Tatim fitimi, tatim mbi të ardhurat pesonale dhe tatim mbi biznesin e vogël) janë më të ulta, megjithse tendenca është gjithnjë në rritje.

Të ardhurat nga *tatim fitimi* kanë patur ecuri mjaft të mire, duke reflektuar permiresimet ne administrim dhe rritjen e kenaqshme te baze se taksueshme, mbeshtetur nga politikat per permiresimin e klimes se investimeve dhe zhvillimin e sektorit privat. Per vitin 2007 te ardhurat nga tatim fitimi perbejne 9.2% te te ardhurave tatimore. Kuadri aktual ligjor i tatim fitimit nuk permban perjashtime dhe lehtesira fiskale, per biznese apo sektore te vecante. Shfuqizimi gradual i ketyre perjashtimeve ka thjeshtuar sistemin, e ka bere me transparent dhe ka reduktuar hapesirat per evazion. Politika e akordimit te lehtesirave dhe perjashtimeve eshte zevendesuar me ate te uljes se vazhdueshme te taksave per biznesin.

Tatimi mbi te ardhurat personale (TAP) aplikohet mbi disa kategori te ardhurash, dhe ka qenë dhe është shume i prekur nga evazoni fiskal dhe mosdeklarimi. Te ardhurat nga kjo takse jane 6.5% e te ardhurave tatimore per 2007 dhe vetem 1.5% e PBB, ne nivelet me të ulëta të rajonit. Shkaku kryesor i kesaj situate eshte numri i madh i te punesuarve në sektorin informal, praktika e mosdeklarimit real te te punesuarve dhe te pagave, per qellim evazoni, kultura e ulet e pagimit te taksave, administrimi i veshtire i kesaj takse per shkak te kompleksitetit te struktures se saj me shkalle progresive.

Tatimi mbi fitimin dhe tatimi mbi te ardhurat personale u reformuan në vitin 2007, me vendosjen e sistemit të taksës së sheshtë, në masën 10 %, që nënkupton taksimin në nivel uniform të të gjitha llojeve të të ardhurave, korporative dhe individuale. Prej me shume se nje dekade, vendet e Europes Qendrore dhe Lindore po ulin taksat mbi korporatat dhe po shfuqizojne lehtesirat dhe perjashtimet tatimore diskriminuese (për t'u pershtatur me rregullat e BE-se per ndihmen shteterore), duke krijuar pershtypjen e nje gare tatimore midis ketyre vendeve drejt normave me

te uleta te taksave. Kjo ecuri eshte pjese e nje tendence nderkombetare drejt uljes se taksimit direkt (tatim fitimi² dhe tatimi mbi te ardhurat personale) dhe rritjes se taksimit indirekt (TVSH, akciza) apo edhe taksës mbi pronën.

Impakti pozitiv që pritet nga vendosja e ketij sistemi, mund te permbliidhet ne keta faktore kryesore: i) *thjeshtimi i administrimit* të tatimit mbi te ardhurat personale, ne krahasim me skemen e tatimit progresiv; ulja e kostos se vleresimit te taksave per t'u paguar, nga ana e kontribuesve; ii) *përmbushja vullnetare*. Vendosja e nje norme të ulet dhe uniforme taksimi shtyn bizneset dhe individet te deklarojne aktivitetet dhe te ardhurat e tyre, duke dale nga ekonomia informale. Ky impakt pritet te jete me i theksuar ne lidhje me deklarimin e te ardhurave te te punesuarve ne sektorin privat. Kjo sjell zgjerimin e bazes tatimore dhe rritjen e te ardhurave ne buxhet. Në lidhje me këtë aspekt, ka disa rezultate parciale qe deshmojne se reforma po jep rezultatet e pritura: po te shohim te ardhurat e mbledhura ne tremujorin e pare te 2008, tatim fitimi dhe tatimi mbi te ardhurat personale kane nje ecuri te mire, me 2.2 miliarde leke me shume se te ardhurat e pritshme nga tatim fitimi dhe 2 miliarde leke me shume se te ardhurat e pritshme nga TAP-i; dhe iii) *nxitja e investimeve*. Ulja e barres tatimore mbi bizneset nuk deformon por i nxit vendimet per investim, duke mbeshtetur zhvillimin dhe zgjerimin e tyre.

Në sistemin tatimor Shqiptar ka dhe një sërë taksash kombetare, me *tiparet e taksimit direkt*, qe rregullohen me nje ligj te vetem. Aktualisht në këtë grup ka 21 taksa, disa prej te cilave janë të vështira për t'u administruar dhe mbledhur. Pevce se karakterizohen nga evazoni i larte dhe e bejne mjaft kompleks sistemin e taksave, ato e shtojne ndjeshem barren tatimore mbi bizneset dhe individet, duke patur nje kontribut te paperfillshem ne buxhetin e shtetit.

C) Kontributi i Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetësore

Burim i rëndësishëm i te ardhurave jane kontributi i sigurimeve shoqerore dhe shendetesore i cilicila kontribon mesatarisht me rreth 17 % në të ardhurat totale. Sistemi i sigurimit shoqeror ne Shqiperi është i tipit “*pay-as-you-go*” (*kontributet e sotëm paguajnë pensionet e sotme*), dhe detyrimin e pageses se kontributeve e kane si punedhenesit ashtu dhe punemarresit. Keto pagesa sherbejne për të financuar një sërë perfitimesh shoqerore, ndër të cilat me i rendesishmi është pensioni i pleqerise.

Që nga 2004, mbledhja e kontributeve të sigurimeve shoqerore dhe shendetesore u unifikua, ne menyre graduale, me mbledhjen e te ardhurave nga TAP-i, nga ana e administrates tatimore. Gjate vitit 2006 u ul ndjeshem barra tatimore mbi punen. Kështu, norma e kontributit për sigurimin shoqeror për punëdhënësin u ul me 9 pikë përqindje, duke arritur në nivelin actual prej 20%, dhe duke konvertuar Shqipërinë një nga vendet me normë më të ulët të kontributit të sigurimeve shoqerorë në rajon dhe shumica e vendeve të BE-së.

Megjithate, kjo takse mbetet ende mjaft problematike persa i perket evazonit dhe mosdeklarimit. Ne perqindje te PBB, te ardhurat nga kontributet e sigurimit shoqeror kane mbetur ne nivele pak

² Sipas “Doing Business 2008”, gjate 2006/2007, 31 vende nga 178 të marra në studim kanë permiresuar sistemet e tyre te taksave dhe 65 vende e kane bere nje gje te tille gjate tre viteve te fundit. Ulja e tatimit te korporatave ka qene reforma me e perhapur në Europa Lindore dhe Azinë Qendrore, ku rreth 1/3 e vendeve reformuan sistemin gjate 2006/2007. Gjithashtu, disa vende (perfshire Shqiperine) ulen pjesen e kontributeve shoqerore te paguara nga punedhenesi.

a shume te njejta ne vite, 4 perqind per tre vite nga 2004 deri ne 2006 dhe 3.8 perqind ne vitin 2007. Kjo ecure eshte rezultat i administrimit te dobet dhe i kultures se ulet te kontribuesve shqiptare lidhur me sigurimin shoqeror. Problemet me te cilat perballet sistemi aktual i pensioneve permbledhen si me poshte:

- numri i ulët i personave të punësuar në tregun e ligjshëm të punës, dhe rënie e shkallës së zëvendësimit.
- norma relativisht të larta të kontributeve krahasuar me përfitimet nga kontributet. Masa e kontributit nuk është e lidhur ngushtë me masën e përfitimit.
- nevoja e përmirësimit të administrimit të mbledhjes së kontributeve për uljen e evazionit në pagesën e tyre;
- përzierja e skemës së pensioneve me atë të ndihmës ekonomike për disa kategori të veçanta pensionesh.



Të gjitha këto probleme tregojnë qartë që brishtësia dhe rreziku fiskal e sistemit aktual në të ardhmen dhe nevojën për reformim të tij. Kështu, diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore arrin mesatarisht rreth 2.4 % e PBB-së.

1.2.2. Politika e Shpenzimeve

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore kanë një tendencë në ulje, nga rreth 33 % e PBB-së në vitin 2000 në rreth 29 %, i shoqëruar kjo më një ulje në shpenzimet korriente, ndërkohë që shpenzimet për investime paraqesin një trend në rritje, që reflekton orientimin drejt një qeverisje të vogël dhe eficiente.


Ritmi i rritjes mesatar të shpenzimeve total buxhetore gjatë periudhës së fundit 10 vjeçarë ka qenë rreth 11 %, dhe gjatë viteve 2000-2007 ritmi ishte më i vogël, rreth 7 %. Realizimin i shpenzimeve gjatë viteve tregon nevojën për rritjen dhe përmirësim e kapacitetit obsebues të ekonomise, si edhe atij programues dhe menaxhues.

Shpenzimet korriente zënë mesatarisht rreth 80 % të totalit, Shpenzimet e personelit, perfaqesojnë pjesën më të lartë në perqindje te totalit të shpenzimeve korente të realizuara. Kjo eshte rrjedhoje e politikës se ndjekur per rritjen e pagave ne sektore te ndryshem te ekonomise, me perparesi ne arsim e shendetesi, si dhe e uljes se kontributeve te sigurimeve shoqerore, me synim formalizimin e



metejshem te ekonomise sone.

Shpenzimet kapitale zënë rreth 19 % të totalit, dhe ka pasur një tendencë në rritje, sidomos vitet e fundit, nga 36 miliardë në vitin 2000 në 57 miliarde ne 1997, dhe duke arritur në një nivel mesatar në rreth 6 % e PBB-së. Norma e rritjes ne vitin 2006 dhe 2007 arriti në 33 dhe 12 % respektivisht. Financimi i investimeve publike është realizuar kryesisht nga financimi i brendshem, i cili ka ardhur në rritje, duke arritur në dy vitet e fundit ne nivelin e më shumë se 80 % të financimit total. Kjo dëshmon, rritjen performancës dhe kapacitetit të ekonomisë shqiptare për të përballuar financimin e investimeve në sektorët kyç si infrastrukturë, arsim, e shëndetësi.




Nga ana tjetër, për herë të parë në vitin 2007, përgatitja e buxhetit është produkt i zbatimit të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI). Të gjitha minsitritë u përfshinë në procesin e planifikimit afatmese, dhe përgatitja e buxhetit u fokusuar më shumë në rezultatet, duke lidhur më mirë buxhetin e shtetit me politikat sektoriale. Ky proces hodhi hapa te rëndësishem ne implementimin e programit te qeverise per periudhen 2008-2009, si edhe për krijimi e një klime të favorshme për biznesit, per zhvillimin dinamik te siper marrjes private dhe terheqjen e investimeve te huaja. Tashmë, programi buxhetor afatmesëm përmirëson programimi buxhetor, afatmesem dhe vjetor, bazuar në shpërndarjen e burimeve sipas fushave më përparësi kombëtare dhe kostimin real të politikave.


Gjithashtu, u hartuan procedura të reja për menaxhimin e investimeve publike, me qëllim identifikimin më të mirë të nevojave të sektoreve të rëndësishëm, realizimin më transparent të shpenzimeve publike, standartizimin, analiza kosto-përfitim, si edhe fokusimi në projektet e medha duke reduktuar fragmentizimin e projekteve të investimeve publike. Nga ana tjetër, u hartua dhe u miratua Ligji i ri mbi “Menaxhimin e Sistemit dhe Procesit Buxhetor”, i cili mundëson përafrimin me standartet ndërkombëtare rreth buxhetimit mbi bazë performace, përmirëson kapacitetin e manaxhimit e sistemit buxhetor, si edhe rrit kapacitetit e planifikimit, buxhetimit, kostimit dhe kontabilitetit, si edhe përmirëson cilësinë e raportimit, transparencën në zbatimin e buxhetit.

1.2.3. Menaxhimi i Borxhit

Gjatë këtyre viteve, si rrejdhojë e paksimit gradual të deficitit buxhetor dhe e një përmirësimi të ndjeshëm në menaxhimin e tij, treguesit e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm të Shqipërisë janë përmirësuar me kalimin e kohës. Stoku i borxhit publik është reduktuar gradualisht, nga nga rreth 60 % që shënonte në vitin 2000 në rreth 54 % të PBB në vitin 2007, duke qënë kështu nën limitin e Paktit European



të Stabilitetit dhe Rritjes. Reduktimi i viteve të fundit është përshpejtuar edhe nga vlerësimi i lekut. Borxhi i brendshëm ka rënë gjithashtu si rezultat i të ardhurave të siguruar nga privatizimi, dhe i përmirësimit të performancës makroekonomike.



Struktura e stokut te borxhit total vazhdon të jetë pothuajse e njëjte gjatë kesaj periudhe, ku raporti i stokut te borxhit te brendshem dhe atij te jashtem ndaj totalit ne terma mesatare është respektivisht 70 % dhe 30 %. Struktura e borxhit publik ka ardhur duke ndryshuar në favor të borxhit të huaj duke i dhënë kështu një hapsirë më të madhe biznesit vendas për t'u financuar me kredi e për të rritur kapacitet e tij në favor

kjo të zhvillimit ekonomik të përgjithshëm. Megjithatë stoku i borxhit të jashtëm ndaj PPB-së është relativisht i ulët krashasuar me vendet e tjera të rajonit, dhe niveli i vjetor i rritjes së borxhit të jashtëm deri në vitin 2003 (më pas është në rënie) qëndron nën nivelin e rritjes vjetore të ekonomisë. Gjithashtu kostot e borxhit janë reduktuar dhe është rritur pesha që zënë në këtë borxh instrumentat financiarë afatgjatë.

Kështu, në drejtim të zgjatjes së afatit të maturimit të borxhit të brendshëm dhe përmirësimit të raportit borxhi i brendshëm/borxhi i jashtëm me qëllim reduktimin e kostos së borxhit publik dhe suportimin e zhvillimit ekonomik, gjatë viteve të fundit u adaptua : i) një politikë e hedhjes në treg të instrumentave të borxhit afatgjatë në vend të instrumentave afatshkurtër duke rezultuar me një strukturë respektive prej 65.5 % (borxh afatshkurter) dhe 34.4 % (borxh afatgjatë) në vitin 2007 nga 77.5 % dhe 22.4 % një vit më parë (2006) ; dhe ii) një përfaqësim i borxhit të jashtëm nga kreditë koncensionare me rreth 77 %. Këto tregues, bashkë me rritjen e rezervës të detyrueshme valutore tregojnë *përballueshmërinë* e deficitit të llogarisë korriente, apo *përballueshmërinë* e financimit të investimeve.

2. Politika makroekonomike dhe përfaqja fiskale në të ardhmen.



Qëllimi i politikës fiskale është sigurimi i stabilitetit makroekonomik dhe formulimi i politikave fiskale nxitëse për zhvillimin e sektorit privat dhe krijimi i klimës së përshtatshme për biznesin. Synimi i politikës fiskale do të jetë aftësia e saj për t'u përgjigjur cikleve të biznesit, duke ruajtur stabilitetin makroekonomik si edhe siguruar dhe nxitur zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Realizimi i qëllimit dhe i objektivave afat-mesëm të politikës fiskale do të mbështetet në kuadrin institucional-ligjor që paraqitet në dokumentat e mëposhtëm të qeverisë:

- Strategjinë Sektoriale të Financave Publike, 2007-2013.
- Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI): 2007-2013.
- Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal, 2009-2011.
- Ligjin e ri për “Menaxhimin e Sistemit dhe Procesit Buxhetor”.

Gjithashtu, politika fiskale afatmesme do të jenë në përputhje edhe me politikat e parashtruar në marrëveshjen me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), në kuadër të rishikimi të katërt të programit për Reduktimin e Varfërisë dhe Rritjes Ekonomike (PRGF) të aprovuar në janar 2006.

Qëllimet e politikave makroekonomike dhe fiskale përmbledhen si më poshtë:

- Do të mbahet një **rritje ekonomike** mesatare më të lartë se 6% në vit dhe me tendencë rritëse duke arritur në 7%.
- Do të ruhet **stabiliteti makroekonomik** nëpërmjet konsolidimit të mëtejshëm fiskal, uljes së vazhdueshme të borxhit të brendshëm, përmirësimit të balancës korrente dhe hartimit të politikës fiskale në përputhje me politikën monetare.
- Niveli i taksave do të ulet dhe do të ruhet niveli 27-29% i PBB-së të të ardhurave publike, krahas reduktimit të informalitetit dhe mirëadministrimit të sistemit **fiskal**. Shpenzimet buxhetore parashikohen që të qëndrojnë në intervalin 30-32% të PBB-se.



Duhet theksuar se marrja e ftesën së anëtarësimi i Shqipërisë për në NATO, në samitin e Aleancës në pranverë të këtij viti, garanton akoma më shumë realizimin e objektivave të mësipërme.

2.1. Parashikimet Makroekonomike

Shqipëria, një prej pak vendeve të cilat kanë patur një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme prej rreth 6 përqind për më tepër se 5 vjet, është duke kaluar një “momentum” pozitiv ekonomik. Kjo konfirmohet më së tepërmi me performancën e ekonomisë gjatë vitit të shkuar, ku me gjithë problemet në sektorin e energjisë elektrike, vlerësohet një rritje ekonomike prej 6 për qind.

Krahas progresit teknologjik e reformimit strukturor të ekonomisë, implementimi gjatë këtij dyvjecari i një serë politikash e reformash makroekonomike, të orientuara qartë nga “filozofia” e stimulimit të rritjes ekonomike nëpërmjet nxitjes së ofertës agregate, i kanë dhënë një shtysë mjaft të fortë ekonomisë. Ndjekja e politikave makroekonomike të mirë-planifikuara e mirë-koordinuara dhe thellimi i mëtejshëm i reformave ekonomike, krahas proceseve të tjera të natyrshme në të cila po kolon ekonomia si, progresi teknologjik, akumulimi i kapitalit e ristrukturimi i ekonomisë drejt një ekonomie gjithnjë e më eficiente, do të sigurojnë që kjo ecure ekonomike të vazhdojë e tillë edhe të paktën në të ardhmen afatshkurtër e afatmesme.

Situata jo e mirë ekonomike që pritet për një numër të konsiderueshëm të ekonomive më të mëdha botërore, sigurisht që përbën një risk potencial edhe për ecurinë ekonomike të vendit tonë. Megjithatë, këtu duhet theksuar që pika e fortë apo promotori kryesor i zhvillimit ekonomik të Shqipërisë qëndron në tregun dhe në aktorët ekonomik të brendshëm të këtij vendi, gjë e cila e vendos ekonominë shqiptare në një pozicion relativisht të mbrojtur ndaj zhvillimeve ndërkombëtare jo të favorshme.

Duke qënë se Shqipëria importon një pjesë të konsiderueshme të produkteve bujqësore e energjetike, elementi i cili e ekspozon më tepër Shqipërinë ndaj zhvillimeve jo të favorshme ndërkombëtare është pikërisht rritja e cmimeve në tregjet ndërkombëtare të këtyre produkteve. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë mbështetjen në një masë të konsiderueshme që Shqipëria ka në dërgesat e emigrantëve, reziku potencial për një pakësim të nivelit të remitancave e intensifikon ekspozimin e Shqipërisë ndaj këtij risku ndërkombëtar.

Reagimi i ekonomisë shqiptare ndaj rritjes së cmimeve të mallrave bujqësor të importuar, pritet të jetë një prirje e fermerëve vendas drejt një rritje të prodhimit vendas bujqësor të këtyre kulturave e rrjedhimisht reduktimi i konsumit nga importet e rritja e kontributit të bujqësisë në rritjen e përgjithshme. Kjo sigurisht do të mbështetet nga politika lehtësuese të qeverisë si në krahun e kërkesës, duke kompensuar plotësisht shtresat e varfra dhe ato me të ardhura të ulta të cilat preken realisht nga rritja e këtyre cmimeve, ashtu dhe në krahun e ofertës duke nxitur me stimuj financiarë fermerët vendas për të rritur prodhuarin këto këtyre kulturave, pa harruar këtu nëse flasim për një afat më të gjatë kohe, investimet në rritje që qeveria po kyen në këtë sektor.

Ecuria e eksporteve shihet si një risk më i vogël për ekonominë shqiptare. Duke analizuar ecurinë dhe strukturën e eksporteve gjatë viteve të fundit, vendet tek të cilat shitet pjesa më të madhe e eksporteve shqiptare, si dhe duke konsideruar “motorët e rinj” që po shtojnë përpara eksportet së fundmi (bumin në eksportet e mineraleve si pasojë e rritjes së ofertës së tyre), dhe një sërë politikash favorizuese që po ndërmerren për bizneset eksportuese, pritet që të paktën edhe për një periudhë afatmesme ritmet e rritjes së eksporteve të qëndrojnë në nivele relativisht të larta. Megjithatë eksportet e disa grup-mallrave, të cilat karakterizohen nga një elasticitet i lartë i kërkesës, sic janë tekstile dhe veshjet e këmbëve, pritet që për dy vitet e ardhshme të kenë një rënie të lehtë në ritmin e tyre të rritjes.

Sa i takon problemeve financiare të cilat dolën se fundmi në pah në SHBA dhe të cilat kanë shkaku themelor i ngadalësimit të ekonomisë amerikane e për rrejdhojë asaj globale, duhet thënë që vendet evropiane në përgjithësi e vecanërisht Shqipëria vlerësohet të jenë relativisht shumë më pak të ekspozuara ndaj këtij risku.

Norma e parashikuar e rritjes reale ekonomike për vitin aktual dhe për katër vitet e ardhshme parashikohet të jetë mbi 6 përqind duke arritur në 7 përqind.³

Në bazë të supozimeve, vlerësimeve, faktorëve e politikave të përmendura më sipër projeksionet për disa nga treguesit makroekonomik kryesorë për periudhën 2008 – 2013, paraqiten në (tabela 7)

³ Një detajim të faktorëve kryesorë, të brendshëm e të jashtëm, politikat makroekonomike e reformat kyçe të qeverisë që pritet të mbështesin perspektivën për një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme gjatë pesë vjeçarit të ardhshëm 2008 – 2013, paraqiten në SKZHI-në dhe në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal.

2.2. Politika Fiskale

Synimi i politikës fiskale është zhvillimi i nje sistemi tatimore që mbështet dhe nxit zhvillimin ekonomik dhe përmirëson klimën e biznesit, si edhe ndjekja e nje strategjie fiskale që të mbështese mbajtjen e një qeverisje të vogël dhe eficente. Kjo strategji synon të përmirësoj menaxhimin fiscal, si edhe të nbështesë reformat e ndërmarra ne fushat e tjera, të cilat kanë si qëllim konvertimin e Shqipërisë në një vend tërheqës për investimet, të brendshme dhe të huaja. Gjithashtu, synohet rritja e kapacitetin të sistemit tatimore për të gjeneruar të ardhura në përgjigje të rritjes ekonomike, për të zgjeruar basën e taksueshme, si edhe thjeshtimi i sistemit tatimor aktual.

2.2.1. Politika e taksave

Politika e taksave do të bazohet në prioritetet strategjike të percaktuara në Strategjinë Kombetare për Zhvillim dhe Integrim dhe në Strategjine e Financave publike, 2007-2013 si dhe në dokumentat e politikës së kuadrit makro për periudha trevjecare.

Rishikimi i sistemit të taksave me fokus të veçantë në shkurtimi i listës së taksave të zbatueshme në Shqipëri, dhe transferimi i disa taksave kombëtare në taksa vendore, si edhe njësimi gradual me standardet europiane i politikave për tatimet indirekte do të jenë prioritetet në fushën e politikës tatimore.⁴

Objektivi me i rendesishem i politikës se taksave do të jetë promovimi i ekonomisë formale, në aspektin e punësimit dhe të investimeve. Vendimet lidhur me ndryshime në taksa do te konsiderojne, para se gjithash, ruajtjen e disiplines fiskale dhe do te bazohen ne analiza kuantitative mbi efektet e tyre ne buxhet. Ndersa te ardhurat shtese te perftuara nga reforma ne administrimin e taksave mund te perdoren per uljen e barres fiskale per individet dhe bizneset.

Bazuar në dokumentat strategjik, drejtimet kryesore të politikës së taksave në të ardhmen mund të përmbliidhen si më poshtë:

a) *Reforma ne sistemin e sigurimeve shoqerore.* Prioriteti strategjik në këtë fushë është përmirësimi dhe ristrukturimi i sistemit publik të pensioneve njeshtyllesh “pay as you go”, per kalimin gradual drejt nje sistemi shumeshtyllesh ndërmjet:

- Forcimi i masave për zbatimin ligjor të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore.
- Reformimi i sistemit aktual nëpërmjet: (i) lidhjes më të mirë midis kontributeve dhe pensioneve; (ii) krijimit të një skemë të pastër pensionesh të bazuar dhe të ballancuar me kontribute; (iii) përmirësimit të administrimit të skemës aktuale.
- Ruajtja e të drejtave të punonjësve që kanë paguar kontribute në sistemin aktual.

⁴ Në këtë kuadër, aktualisht është në proces rishikimi i taksave kombëtare në drejtim të: rishikimit të nivelit actual të taksave nacionale; kalimin e disa taksave kombëtare në taksa vendore; shfuqizimin e disa taksave kombëtare, si edhe kalimin e disa të tjerave në tarifa shërbimi.

- Hartimi i kuadrit ligjor për krijimin dhe mirëfunksionimin të sistemit shumëshytlës
- Planifikimi dhe menaxhimi i kalimit drejt sistemit të ri me shumë shtylla.

Niveli dhe mbledhja e kontributeve do të ndikohet edhe nga rritja e numrit të kontribuesve, prej 410 mijë deri në fund të qershorit 2008, mbështetur në masat për rritjen e ndergjegjesimit të popullatës në kuadër të programit PRGF-së me FMN. Verifikimi i dosjeve, ngritja e arkivit digital, si edhe lidhja online e subjekteve, janë gjithashtu prioritetet në këtë fushë.

Gjithashtu, reforma në sistemin shëndetësor do të jete element tjetër i rëndësishëm i politikës fiskale, i cili do të përfshijë si financimin⁵ ashtu edhe paketën e shërbimeve,

b) Përafrimi me legjislacionin e Bashkimit Europian. Një nga sfidat më të vështira të politikës së taksave në Shqipëri për vitet në vijim është përafrimi i legjislacionit tatimor me normativen e BE-së, për ta pershtatur sistemin e taksave me kërkesat e BE dhe me rregullat e funksionimit të tregut të përbashkët europian. Kjo implikon ndryshime në menyrën e funksionimit të tyre, legjislacionin, dhe në administrim.

Ndryshimet më të shpejta në këtë kuadër i përkasin taksimit indirekt (TVSH dhe akcize), meqenese për këtë lloj taksimi ka një kuadër ligjor europian të harmonizuar. Deri tani puna është përqendruar në analizimin e legjislacionit shqiptar për TVSH-në dhe akcizën, për të nxjerre në pah elementet e ndryshimit me normativen europiane dhe drejtimit për permiresim. Kriteret e regjistrimit për TVSH-në, përcaktimi i përkufizimeve, si edhe kriteret për rimbursimin e TVSH-së, në Shqipëri duhet të pershtaten me Direktiven 2006/112/EC.

Elementet kryesore të sistemit të akcizave në Shqipëri, si përkufizimet, detyrimi për të paguar, autorizimi i akcizes, regjimi i pezullimit tatimor janë në përputhje me kërkesat e BE-së. Por ndryshimet kryesore të legjislacionit shqiptar me ato të harmonizuar komunitar për akcizat kanë të bëjnë me përcaktimin e produkteve, struktura dhe tarifatat e akcizës. Ka mosperputhje në lidhje me normat e taksimit krahasuar me normat e harmonizuara të BE-së.

Akcizat në Shqipëri janë më të ulëta se ato të vendosura (si tarifa minimale) në BE, dhe sipas raporteve të FMN të ardhurat nga akcizat janë sa rreth gjysma e mesatares së rajonit. Kjo, tregon që ka hapësirë në të ardhmen për të rritur të ardhurat nga akciza. Gjithashtu, Direktiva 2003/96/EC shprehet për ristrukturimin dhe harmonizimin e kuadrit të taksimit për produktet energjitike dhe energjisë elektrike në vendet anetare.

2.2.2. Administrimi i Taksave

Thjeshtimi i akteve tatimore ligjore dhe nënligjore, përmirësimet administrative me qëllim uljen e pengesave burokratike, shmangia e kontakteve taksapagues-inspektor tatimor, dhe orientimi drejt e-filing, është tjetër prioritet në politikën tatimore.

Totali i të ardhurave buxhetore nga taksat varet nga tre faktore: politika e taksave, administrimi i tyre dhe baza e taksueshme. Baza e taksueshme lidhet ngushtë jo vetëm me strukturën e PBB-së

⁵ Aktualisht më shumë se 50 % e shpenzimeve për shërbime shëndetësorë mbulohet nga buxheti i shtetit.

të një vendi, që në rastin e Shqipërisë kufizohet ndjeshëm nga pesha e sektorit bujqësor, por një faktor tjetër i rëndësishëm në zgjerimin e bazës së taksueshme është përmirësimi i administrimit tatimor, duke rritur përmbushjen vullnetare të detyrimeve dhe pajtueshmerinë e taksapaguesve me detyrimet e tyre ndërmjet përmirësimit të funksionimit të administrates tatimore, cilësinë e shërbimit ndaj tatimpaguesit, si edhe thjeshtimin e procedurave.

Po t'i referohemi raportit "*Doing Business 2008*", një nga reformat me të rëndësishme në lehtësimin e pageses së taksave gjate 2006/2007 ka qene *thjeshtimi i procedurave të pageses*, duke përdorur gjërësisht pagesën e taksave "on-line"⁶. Në Shqipëri, *e-filing* është një nga komponentet e projektit "*Millennium Challenge Albania Threshold Agreement*" për zhvillimin e një sistemi tatimor të integruar. Projekti, në bashkëpunim me DPT-në po përgatit dhe po teston modulet IT-së për deklarimin dhe pagesën "on-line" të TVSH-së, tatim fitimit dhe tatimit mbi të ardhurat personale, duke pasur si objektivi afatshkurter mbulimin i taksapaguesve për Tiranën dhe Durrësin.

Tjetër masë e rëndësishme do të jetë *thjeshtimi i administrimit të taksave* ndërmjet qartësisë së ligjeve dhe akteve nën ligjore dhe qartësia e rregullave që lidhen me kontrollet tatimore. Shpesh kontrollet tatimore dhe kontaktet e shpeshta taksapagues/inspektor krijojnë hapesira për praktika korruptive dhe sjellje abuzive nga autoritetet tatimore. Për këtë, do të vendoset një sistem auditimi që seleksionon në bazë të riskut dhe mbi bazen e kriterëve objektive. Skema e auditimeve do të kalojë nga një skemë gjithëpërfshirëse sic është aktualisht, në një me të ngushtë, ose të fokusuar në çeshtje të vecanta⁷.

Forcimi i menaxhimit të pajtueshmerisë me taksat do të jetë objektivi strategjik i punës së administrates tatimore. Pajtueshmeria me taksat përkehet në shlyerjen vullnetare të detyrimeve ndaj shtetit të individëve dhe bizneseve. Realizimi i këtij objektivi punë kërkon: monitorim të nivelit të pajtueshmerisë të taksapaguesve me detyrimet e tyre fiskale në lidhje me regjistrimin, deklarimin, pagesën, mos raportimin dhe menyrat e tjera të evazionit fiskal.

Rritja e kapaciteteve të administratës tatimore dhe doganore, dhe institucionalizimi i masave për uljen e korrupsionit. Ulja e korrupsionit në administratën tatimore është faktor kyç për rritjen e besueshmerisë së saj dhe për pasojë dhe për shlyerjen vullnetare të detyrimeve. Do të forcohet puna e njesisë Anti-Korrupsion të ngritur brenda administrates tatimore dhe do të rishikohet Kodi i Etikës. Administrata tatimore do të mbështetet nga projekti *Millennium Challenge Albania Threshold Agreement*, në mënyrë që duke përdorur avantazhet e IT, të përmirësojë proceset e brendshme të punës në administratë si dhe strukturën organizative bazuar në funksione administrative. Do të forcohen procedurat e brendshme të auditimit, nëpërmjet kryerjes së hetimeve mbi parregullsitë në punë, dhe zbatimit të procedurave të ankimit. Përmirësimë do të ketë në: (i) procesin e rimbursimit të TVSH. Do të vendoset dhe një sistem rimbursimi, përmes së cilit kërkesat për rimbursim do të paguhet në mënyrë automatike, pas verifikimeve përkatëse; (ii) transformimin e plote të zyrës së Taksapaguesve të Medhenj në një zyrë shërbimi. Të gjitha aktivitetet që lidhen me shërbimin, auditin, mbledhjen me forcë, vlerësimin, kontabilitetin, të përqendrohen në këto zyre për të gjithë taksapaguesit e medhenj; iii) shtrirja dhe forcimin e

⁶ Sipas këtij raporti, rreth ¼ e vendeve të botes kanë mundësuar pagesën on line të taksave nga kompanitë.

⁷ Studimet demostrojnë që vendet që kryejnë kontrolle tatimore mbi bazen e analizës së riskut kanë të ardhura më të larta në raport me PBB (rreth 18 përqind më shumë se mesatarja) edhe kur niveli i taksave është i ulët.

perdorimit te modulit te riskut te sistemit ASYCUDA per kontrollin ne deget doganore; si edhe përgatitja e raporteve mbi situatën e borxhit tatimor dhe mbi rimbursimin e TVSH (shumë e kërkuar, paguar dhe refuzuar).


Lidhur me taksat me te goditura nga evazioni, tatim mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqerore, masat do te perqendrohen ne: thjeshtimin e procedurave per deklarimin dhe mbajtjen ne burim te TAP dhe kontributeve; intensifikimin e kontrolleve mbi detyrimet e deklarimeve dhe pagesave, dhe auditimet e perbashketa per te dyja taksat, ne menyre qe te shfrytezohen ekonomite e shkalles dhe te rriten te ardhurat, si pasoje e kombinimit te dy funksioneve. Ne periudhen afatgjate do te vendoset deklarimi integral i të ardhurave, i shoqëruar nga një program për rritjen e pajtueshmerisë së individeve me detyrimet tatimore, bazuar në kontrolle efektive mbi deklarimin dhe pagesen, ne procese auditimi efektive dhe administrim eficient te pagesave te pashlyera.

2.2.3. Decentralizimi Fiskal

Përmirësimi i kuadrit fiskal për qeverisjen vendore, në drejtim të rritjes së shkallës së autonomisë fiskale dhe kapaciteve vendore për mbledhjen e të ardhurave dhe realizimin e financimeve, është tjetër përparësi strategjike në menaxhimin financiar publik⁸.

Thellimi i procesit të decentralizimit fiskal, nepermjet rritjes se autonomise financiare lokale nga transferimi i taksave te reja njesive te pushtetit vendor, bazuar në portofolit e funksioneve, dhe mireadministrimit të atyre ekzistuese do të jetë objektivi strategjik në fushën e decentralizimit fiskal. Aktualisht, ministria e financave eshte në proces reformimi të sistemit të taksave kombetare. Disa prej tyre do te shfuqizohen, disa te tjera do te kalojne ne taksa lokale, per t'u administruar, mbledhur dhe perdorur nga njesite e pushtetit vendor, disa te tjera ne tarifa sherbimi, dhe do të rishikohet niveli i disave të tjera.

Aktualisht nën administrim të qeverisjes vendore për vendosjen, mbledhjen dhe administrimin e tyre janë 9 lloje taksash vendore. Ne baze te legjislacionit ne fuqi, pushteti vendor vendos, për bazën e taksueshme dhe nivelin e taksës, brenda kufijve të vendosur nga ligji, për procedurat e administrimit dhe mënyrën e mbledhjes se taksave vendore, për përjashtimin ose lehtësimin e kategorive te ndryshme ne pagimin e taksave, për përdorimin e te ardhurave te grumbulluara nga keto taksa.



⁸ Aktualisht është në proces rishikimi i sistemit të taskave vendore me synim rishikimin e nivelit të disa taksave vendore; si edhe transferimin e disa te tjera në përputhje me funksionet e pushtetit vendor. Ne qoftëse do të rritet: 2 herë taksa mbi pronen, toka dhe ndertesë; do të rritet në 5 % taksa mbi infrastrukturën, si edhe do të kalojë në taksë lokale, taksa për peshkimin dhe e aktave dhe pulles, të ardhurat për pushtetin vendor do të rriten me 37 % ose rreth 9 miliarde lekë.

Të ardhurat e veta të pushtetit vendor nga taksat, tarifat dhe të ardhurat jotatimore, kanë ardhur në rritje të kënaqshme, nga 0.59% e PBB-së në vitin 2000 kanë arritur në 1.34% e PBB në vitin 2006, megjithse në vitet e fundit performanca e të ardhura nga pushteti lokal nuk ka qenë në nivelin e duhur si rezultat i kapaciteteve të dobëta administrative si edhe i paqartësive në caktimin e përgjegjësive dhe kompetencave për autoritetin vendor. Pesha e tyre në burimet e financimit të shpenzimeve vendore është rritur gjithashtu ndjeshëm.

Megjithate, Shqipëria rezulton me përqindjen më të ulët të të ardhurave të pushtetit vendor dhe të shpenzimeve lokale në raport me PPB-në, në krahasim e vendet e marra në studim, pamvarësisht nga portofoli i funksioneve.⁹

Ligji i ri për taksat vendore i tetorit 2006 rriti ndjeshëm autonominë fiskale, dhe vendosi një taksë të vetme, vendore, mbi biznesin e vogël, duke eliminuar komponentin e ndarjes së të ardhurave nga tatim fitimi, nepermjet shfuqizimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, që mbledhej dhe administrohej nga administrata tatimore qendrore dhe të ardhurat e kalonin pushtetit vendor. Ligji vendos nivele baze të taksës, dhe i jep të drejtën pushtetit vendor të vendosë nivelet e taksës, në kufijte e lejuar nga ligji (+ ose - 30% të nivelit baze). Gjithashtu, që nga viti 2005 presioni fiskal mbi biznesin e vogël ka qenë në ulje. Me ndryshimet fiskale 2005, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin u pergjysmua, ndërsa nga ana administrative u hoq detyrimi për regjistrim të përvitshëm të këtyre bizneseve. Edhe reforma e vitit 2006, me bashkimin e dy taksave, e uli nivelin tatimor. Pas një periudhe tranzitore, që nga muaji mars i 2007, kjo taksë i ka kaluar teresisht për administrim administratës të pushtetit vendor. Problemet e administrimit të bashkuar me uljen e nivelit të taksimit janë arsye kryesore të rënies së të ardhurave nga taksat e biznesit të vogël vitet e fundit.

Për sa më sipër, forcimi i administrimit mbetet thelbësor për rritjen e të ardhurave nga kjo taksë dhe në këtë kuadër bashkëpunimi i ngushtë midis administratave në nivel qendror dhe lokal luan rol kyç¹⁰. Nderkohe është kompletuar baza ligjore për vendosjen e një sistemi unik administrativ për percaktimin e bazës së taksueshme. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit midis administratës tatimore qendrore dhe asaj lokale është i domosdoshëm për të shmangur:

- Problemet e mbivendosjes së përgjegjësive për mbledhjen e taksave nga biznesi i vogël (kujtojmë këtu se tatimi mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqërore të bizneseve të vogla vazhdojnë të mbledhen nga administrata qendrore);
- Vështiresitë në identifikimin e atyre taksapaguesve biznese që kalojnë pragun e detyrueshmërisë për regjistrimin në TVSH dhe që mund të kenë interes për të qendruar në kategorinë e biznesit të vogël, duke mos deklaruar vullnetarisht xhiron e tyre reale¹¹

Gjithashtu, nisur nga fakti që taksimi aktual mbi pronën, dhe konkretisht i ndërtesave nuk reflekton vlerën reale të tregut të banesave¹², është në diskutim një propozim për rritjen e kesaj

⁹ Të ardhurat e veta të pushtetit vendor në % të PBB-së për vendet e rajonit janë më të larta: Kroacia 7.5 %, Bullgaria 6.5 %, Rumania 6.7 %, Sllovenia 9.5. Për vendet e tjera të zhvilluar (Itali, France, Angli, Gjermani) ky raport është akoma më i lartë, mbi 10 % e PBB-së.

¹⁰ Janë rreth 350 njësi të pushtetit vendor, që do të merren me mbledhjen e taksës së biznesit të vogël.

¹¹ International Monetary Fund, fiscal affairs department, "Important steps towards international standards in tax administration", tetor 2007

¹² Të ardhurave nga taksat mbi pronën në shumë shtete (Bullgaria, Çekia, Estonia, Kroacia, Hungaria, Lituania, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia) është mesatarisht rreth 0.54 % e PBB-së ose rreth 25 % e të ardhurave të pushtetit


takse, sipas bashkive dhe komunave, dhe diferencimin e takses vetem sipas destinacionit te perdorimit te ndertesese dhe jo vitit te ndertimit, sic parashikon sistemi aktual.

Gjithashtu, eshte ne diskutim edhe vendosja e takses mbi truallin urban, qe aktualisht eshte i pataksuar si dhe rishikimi i takses mbi token bujqesore. Ndryshimet qe po i behen sistemit te taksave vendore, me rritjen e nivelit te disa taksave vendore dhe kalimin e disa taksave kombetare ne taksa vendore, do te kene impakt pozitiv ne te ardhurat e veta te pushtetit vendor, ne rritjen e autonomise vendore, si edhe forcimin e decentralizimit fiskal.

2.2.4. Parashikimi i te ardhurave

Për sa më sipër dhe bazuar në parashikimet makroekonomike pritet një rritje e rëndësishme e konsiderueshme pathuajse të gjitha kategoritë e të ardhurave (Tabela 8)¹³. Ndër elementët kryesorë të politikës së taksave mund të përmenden:

- *Mbajtja kostante te normes se TVSH-se.*
- *Efektet që priten nga zbatimi i politikës së taksës së sheshte për tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimi mbi fitimin.*
- *Rishikimi i taksave nacionale në nivelet e tyre dhe në kuadër të reformës së decentralizimit fiskal.*
- *Rishikimi i nivelit të akcizës së mallrave të forta.*
- *Ulja e të ardhurave nga taksa doganore si rezultat i zbatimit të angazhimeve tarofor në Marrëveshjen e Ndërmjetme BE-Shqipëri, CEFTA, MTL me Turqinë.*
- *Norma e kontributit per sigurime shoqerore eshte parashikuar te mbetet e njejte me nivelin e aplikuar ne shtator te vitit 2006, si pasoje e rishikimit te skemes ekzistuese dhe rishikimi i politikës dhe masave së përmirësimit të kontributeve shoqërore dhe rishikimit të reformës së pensioneve.*



Parashikimi i të ardhura është bazuar gjithashtu edhe në treguesit makroekonomik, rritje reale ekonomike dhe inflacion, përmirësimet administrative e strukturore, si edhe ne trendin historik të realizimit.

vendor, ndërkohë që Shqipëria per vitin 2006 ka realizuar 1.3 miliarde, që i korrespondon me 10% te te ardhurave të veta nga taksa mbi pronen. Gjithashtu, niveli i takës së pasurisë në Shqipëri është shumë i ulët në krahasim me vendet e tjera: për Tiranën niveli mesatar i taskses për apartamentet e banimit varion nga 0.01-0.02 % e vlerës fiskale të pasurisë (për bashkite e tjera është më i vogël), ndërkohë që ky tregues në Itali është rreth 0.4-0.7 %, Bullgari 0.15 %, dhe Rumani 0.2 %.



¹³ Parashikimet fiskale, të ardhurat, shpenzimet dhe borxhi, janë provizore.

2.2.5. Politika e shpenzimeve

Prioritet kryesor në menaxhimin financiar në lidhje me politikën e shpenzimeve janë: i) përmirësimi i Programimi buxhetor afatmesëm dhe vjetor, që do të mbështesë fuqimisht shpërndarjen e burimeve në fushat me përparësi kombëtare duke forcuar disiplinën fiskale, duke rritur efikasitetin dhe frytshmërinë e shpenzimeve publike, si edhe duke u bazuar në një kostim real të politikave; dhe ii) përmirësimi i planifikimit dhe menaxhimit të investimeve publike, nëpërmjet rritjes së madhësisë mesatare të projekteve dhe pakësimit të numrit të tyre duke u mbështetur në procedurat e reja të menaxhimit të investimeve.

Shpenzimet buxhetore parashikohen të qëndrojnë në intervalin 30-32% të PBB, ku përjashtim bën viti 2008 që ndikohet nga rritja e financimit të huaj për rrugën Durrës-Kukës-Morinë. Në këtë vlerësim nuk përfshihet përdorimi i të ardhurave nga privatizimet strategjike (Tabela 8).

Shpenzimet për personelin. Shpenzimet për personelin e administratës publike do të qëndrojnë konstante në vitet në vijim në raport me PBB, rreth 6.3 %, që do të thotë një indeksim i plotë me nivelin e inflacionit dhe rritje reale e diferencuar për sektorë prioritarë, arsim dhe shëndetësi, në përputhje me objektivat e reformës në administratën publike.



Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes. Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes parashikohen të rriten në terma realë për tre vitet e ardhshme. Kjo rritje do të orientohet kryesisht në shpenzimet e mirëmbajtjes, si rrjedhojë e rritjes së nivelit të investimeve gjatë këtyre viteve. Brenda kësaj kategorie, shpenzimet operative të parashikuara për administratën do të vijnë duke u ulur në raport me PBB, duke krijuar mundësinë për rritje më të shpejtë të shpenzimeve për mirëmbajtjen në sektorët prioritarë, si infrastrukturë, arsim e shëndetësi, por edhe të shpenzimeve për politika specifike sektoriale siç janë ato të mbështetjes në bujqësi, nxitjes së

eksporteve, mjedisit etj.

Shpenzimet korriente do të ndjekin një trend rritës, si rrjedhojë e rritjes së shpenzimit për mirëmbajtje, mesatarisht rreth 16 % nga viti në vit, duke mbështetur investimeve në rritje në infrastrukturën, kryesisht rrugore. Gjithashtu, edhe shpenzimet operative dhe mirëmbajtjes në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë parashikohen të rriten me rreth 21% në vit.

Shpenzimet kapitale parashikohen mesatarisht në nivelet mbi 6-7% e PBB-së, kjo në varësi edhe të nivelit dhe ecurisë së disburseve të financimeve të huaja. Pas ritmeve të larta të investimeve në vitet 2007 dhe 2008, investimet do të stabilizohen në këto nivele, duke mundur që një pjesë


e mirë e alokimeve buxhetore të fillojë të kalojë tek mirëmbajtja. Investimet do të vazhdojnë të mbështesin sektorët prioritarë, si arsim, shëndetësi e infrastrukturë.

Financimi i investimeve publike me burime të brendshme do të rritet me rreth 15 % në vit, duke arritur në vitin 2011, në rreth 70 % të financimit total dhe 4.2 % të PBB-së. Ndërsa, niveli i investimeve të huaja është parashikuar të ketë një trend zbritës në terma reale. Në këto nivel nuk janë reflektuar plotësisht angazhimet e reja në kuadër të marrëveshjes IPA me BE, pasi ende nuk ka një informacion të plotë mbi shumën dhe ndarjen sektoriale. Fondi i investimeve nga *burime të huaja* është përcaktuar duke mbajtur parasysh projektet e parashikuara në dokumentin e mëparshëm të PBA 2008-2010, si dhe tavanet sektoriale të përcaktuara me FMN-ne për kredite komerciale. Financimi i huaj është parashikuar të ulet çdo vit, përveç vitit 2008 të cilat lidhen me financimin e rrugës Durrës-Morinë, që reflekton nivelin në rritje të zhvillimit ekonomik dhe financiar të Shqipërisë dhe kapacitetin financiar në rritje.

Fondet për investime (*me investim të brendshëm*) të parashikuara për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për periudhën 2009-2011, vazhdojnë të zënë peshën më të madhe në totalin e investimeve, duke shënuar një rritje mesatarisht me 18% në vit. Fondet e alokuara për këto qëllime do të bëjnë të mundur: përfundimin e aksit rrugor Durrës-Kukës-Morinë; finalizimin e Korridoreve Veri – Jug dhe Lindje – Perëndim; rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës rrugore turistike; ndërtimin e ujesjellesave të rinj dhe rehabilitimin e atyre ekzistues, përfshirë këtu dhe sistemin e kanalizimeve.

2.2.6. Menaxhimi i Borxhit

Menaxhimi i huamarrjes së qeverisë synon plotësimin e nevojave për financim të saj në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, ndërmjet politikave të financimit që do të orientohet drejt instrumentave afatgjatë me qëllim uljen e kostos së borxhit, si edhe uljen e riskut të normave të interesit dhe të rifinancimit¹⁴. Kjo, do të arrihet duke zhvilluar tregun e brendshëm të letrave me vlerë si edhe diversifikimit të instrumentave të financimit, si edhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme strukturën midis borxhit të jashtëm dhe atij të brendshëm në favor të uljes së raportit borxh i brendshëm/PBB.




Pakesimi i stokut të borxhit të brendshëm¹⁵, si rezultat i rënies së deficitit, pritet që të vazhdojë në të ardhmen si pasojë e: i) reduktimit të mbështetjes në burimet e brendshme për të financuar deficitin, për shkak të kostos së lartë të interesave të stokut të borxhit të brendshëm; ii) përdorimi

¹⁴ Treguesi i ditëve të maturimit mesatar të borxhit është rritur në 409 ditë në dhjetor të 2007, nga 284 ditë që ishte në fund të vitit 2006.

¹⁵ Vleresimet empirike tregojnë se një rritje me një pike prej 1% të PBB-së në financimin e brendshëm redukton rritjen e PBB-së për frymë me një të tretën e një pike përqindjeje. Gjithashtu, rregullimet fiskale të bazuara në reduktimin e financimeve të brendshme kanë rreth një herë e gjysëm efekt mbi rritjen sesa rregullimet e bazuara mbi të dy burimet e financimit, brendshëm dhe jashtëm.

i fitimeve ne te ardhura nga administrimim i taksave, si edhe i të ardhurave nga privatizimi për të reduktuar borxhit e brendshem. iii) rritja graduale e aksesit ne burimet e financimit tregtare afatgjate ne tregjet e huaja te kapitalit bazuar në përmiresimin e performances makroekonomike, krijimi i nje eksperience të shendoshe në lidhje me dokumentimin dhe pagesat e detyrimeve debitore (duke perfshire shlyerjen e borxhit te prapambetur) dhe përmiresimi i treguesve te kreditimit ne tregjet nderkombetare.



Kështu, stoku i borxhit parashikohet të ulet në rreth 47 % të PBB-së në vitin 2013, mbajtja e huamarrjes së brendshme ne nivelet rreth 2 % të PBB-së, dhe zgjatja e afatit të maturimit, duke rritur ate në nivelet aktuale të borxhit afatshkurtër. Ndërsa kostojo e borxhit të brendshme ka një tendencë në rënie pas vitit 2008, dhe ndërkohë që ajo e borxhit të jashtem mbahet kostantë.

3. Konkluzionet

- Shqipëria ka qenë e sukseshme në arritjen e normave të larta të rritjes ekonomike dhe ndjekjes së reformave strukturore gjate viteve të fundit. Pas ngadalësimit në vitin 2002 për shkak të mungesës së energjisë elektrike, rritja e PBB-së është rritur, duke arritur në nivelin 6 për qind në 2007. Kërkesa e agreguar (konsumi dhe investimet) të mbështetur dhe transfertat private nga jashte (remitancat) kanë qenë forca shtytëse për rritjen e PBB-së.
- Implementimi gjatë viteve të fundit i një serë politikash e reformash makroekonomike, tregojnë qartë orientimin nga “filozofia” e stimulimit të rritjes ekonomike nëpërmjet nxitjes së ofertës agregate.
- Qëndrueshmëria makroekonomike në Shqipëri është ruajtur gjatë viteve të fundit. Politikat monetare dhe financiare e kanë mbajtur nën kontroll inflacionin, kanë nxitur besimin në monedhën kombëtare dhe kanë shtuar kredinë për sektorin privat.
- Marrja e ftesës për anëtarësimin në NATO do të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe garantoj tërheqjen e investimeve huaja, duke krijuar kushte të favorshme për anëtarësimin e mëtejshëm në BE.
- Prespektiva për një rritje të lartë dhe qëndrueshme është positive, duke u mbështetur në konsolidimin e vazhdueshëm fiscal dhe përmirësimin në cilësinë e rregullimeve fiskale për të mbështetur investimet private; përshpejtimin e reformave strukturore të cilat kanë si synim përmirësimin e mjedisit të biznesit, cilësinë e infrastrukturës dhe të qeverisjes së sektorit public, si dhe nxitjen e eksporteve.
- Reformat strukturore parashikojnë të nxisin rritjen e investimeve të brendshme bruto (publike dhe private), duke arritur në 32 % të PBB. Investimet do të mbështeten nga kursimet të brendshme më të medha. Transfertat nga jashtë do të vazhdojnë të jenë një

kontribues i rëndësishëm në të ardhurat kombëtare e rrjedhimisht në kursimet private. Kapaciteti në rritje për të kursyer e investuar do të lehtësohet nga reformat strukturore në sektorin bankar dhe atë të ndërmarrjeve, konsolidimi fiskal dhe rritja e konkurueshmërisë.

- Përmes zbatimit të një serë masash fiskale bilanci i përgjithshëm buxhetor parashikohet të përmirësohet, duke arritur në 3 % të PBB-së në 2013. Zhvillimet fiskale do të krijojnë hapësira më të mëdha financimi për sektorin privat.
- Gjatë viteve të ardhëshme Shqipëria mund të rrisë në mënyrë graduale huamarrjen jokoncesionare pa e përkeqësuar treguesit e borxhit, duke mobilizuar burimet e brendshme. Raporti i borxhit publik ndaj PBB-së do të ulet nga rreth 54 për qind në vitin 2007 në rreth 47 për qind në vitin 2013.
- Gjithashtu kosto e borxhit publik do të reduktohet duke zëvendësuar gradualisht huamarrjen afatshkurtër të brendshme të kushtueshme me financim afatgjatë të jashtëm më pak të kushtueshëm, dhe duke zgjatur periudhën e maturimit të borxhit të brendshëm. Me ristrukturimin e borxhit të brendshëm drejt një borxhi me amaturim afatgjatë dhe me rritjen e konsolidimit fiskal, financimet bruto të pidentifikuara bien dhe burimet financiare dominohen gjithnjë nga të ardhurat e qeverisë, gjë e cila del në pah edhe me uljen e raportit të borxhit publik ndaj PBB në vite.
- Liberalizimi i tregtisë dhe integrimi i Shqipërisë në tregjet rajonale dhe botërore janë sfida ekonomike të radhës. Liberalizimi i tregtisë do të vazhdojë të rritet duke avancuar edhe me marrveshjet bilaterale-multilaterale me vendet e rajonit. Kjo kërkon që reformat në fushën e taksave të vazhdojnë.
- Përmirësimi i klimës së biznesit, zhvillimi sektorit financiar, bankar dhe jo-bankar, janë faktor kryesor në rritjen ekonomike dhe rritjen e investimeve.
- Reforma në sistemin e sigurimeve shoqërore do të përmirësojë qëndrueshmërinë financiare të sistemit, por gjithashtu supozon një risk fiskal në vitet e para të implementimit.
- Megjithëse janë parashikuar të ndërmerren një sërë reformash, stabiliteti makroekonomik dhe fiskal mund të kërcënohet nga një sërë risqesh që mund të përmbliken në presionet financiare prezente së fundmi në tregun ndërkombëtar, pritshmëria për rënie ekonomike globale, dhe paqëndrueshmëria e çmimit të energjisë dhe naftës në tregun botëror e së fundi rritja e çmimit të produkteve bazë ushqimore. Këtij risku i shtohet dhe ai i ardhur prej rritjes së lartë të kredidhenies në ekonomi, duke rritur presionet infalcioniste nga ana e kërkesës.
- Megjithëse investimet në sektorin e energjitikës, përmirësimi i performancës së sektorit, si edhe privatizimi i sektorit të shpërndarjes, priten të ulin ndjeshëm riskun, ende furnizimi me energji elektrike mund të përbëjë dhe një risk potencial për qëndrueshmërinë e performancës së lartë ekonomike.
- Një kombinim sa më eficient i politikave fiskale dhe monetare do të jetë një mjet i rëndësishëm për parandalimin e krizave të papritura.

4. ANEKS

Tabela 1. Treguesit kryesorë makroekonomik

Treguesit	Njësia	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Popullsia	Milion	3.1	3.1	3.1	3.1	3.1	3.1	3.1	3.2
Inflacioni (mesatar)	%	0.1	3.1	5.2	2.4	2.9	2.4	2.4	2.9
Kursi i këmbimit	Lek / USD	143.5	143.5	140.2	121.8	102.8	99.9	98.1	90.4
Kursi i këmbimit	Lek / Euro	-	-	132.4	137.5	127.7	124.2	123.1	123.6
PBB	Lek miliardë	523.0	583.4	622.7	694.1	751.0	817.4	893.0	979.0
PBB	USD miliardë	3.6	4.1	4.4	5.7	7.3	8.2	9.1	10.8
Rritja reale e PBB	%	6.7	7.9	4.2	5.8	5.7	5.8	5.5	6.0
PBB për banor	Lek mijë	171.0	190.4	201.9	223.7	240.7	260.7	283.6	309.6
PBB për banor	USD	1,191	1,327	1,440	1,837	2,343	2,611	2,887	3,402
Investimet totale	% të PBB	31.7	38.4	37.9	40.5	37.2	36.3	29.1	29.2
<i>nga të cilat publike</i>	% të PBB	6.9	7.4	6.1	4.5	5.1	4.7	5.7	5.9
Të ardhurat totale	Lek miliard	130.6	145.6	154.6	167.2	184.4	204.2	229.4	251.6
Të ardhurat totale	% të PBB	25.0	25.0	24.8	24.1	24.5	25.0	25.7	25.8
Shpenzimet totale	Lek miliard	170.3	186.0	192.5	201.2	222.4	232.3	258.8	282.7
Shpenzimet totale	% të PBB	32.6	31.9	30.9	29.0	29.6	28.4	29.0	28.9
Shpenzimet korrente	% të PBB	25.5	24.1	24.8	24.4	24.5	23.7	22.9	23.0
Shpenzimet kapitale	% të PBB	6.9	7.4	6.1	4.5	5.1	4.7	5.7	5.8
Deficiti i përgjithshëm	Lek miliard	-39.7	-40.4	-37.9	-33.9	-38.1	-28.2	-29.4	-31.0
Deficiti i përgjithshëm	% të PBB	-7.6	-6.9	-6.1	-4.9	-5.1	-3.4	-3.3	-3.2
Borxhi publik total	% të PBB	60.2	58.5	63.9	61.5	58.3	56.6	56.1	54.2
Borxhi i brendshëm	% të PBB	43.2	41.3	41.9	40.5	39.3	40.0	39.1	37.7
Borxhi i jashtëm	% të PBB	16.9	17.2	22.1	21.1	19.0	16.6	17.0	16.4
Pretendimet neto ndaj qeverisë	% të PBB	43.1	41.0	41.2	38.9	37.1	34.6	32.8	31.8
Kredia për ekonominë	% të PBB	4.2	4.7	6.2	7.3	9.2	14.8	21.4	29.0
Kreditë nën standarte	% të totalit të kredive	45.5	11.3	10.1	7.7	7.3	6.1	6.5	8.1
Kreditë nën standarte	% të PBB	1.9	0.5	0.6	0.6	0.7	0.9	1.4	2.3
Paraja e gjerë	% të PBB	72.1	70.8	71.6	68.3	70.9	74.0	78.9	84.1
Bilanci i pagesave	USD milion	131.9	145.0	28.6	99.6	288.6	150.7	265.1	202.3
Bilanci tregtar	USD milion	-821	-1027	-1155.2	-1336.3	-1576.9	-1820.4	-2122.7	-2943
Bilanci tregtar	% të PBB	-22.5	-25.3	-26.0	-23.4	-21.6	-22.2	-23.3	-27.4
Eksportet	USD milion	255.4	304.6	330.2	447.2	599.8	656.3	792.9	1078.0
Eksportet	% të PBB	7.0	7.5	7.4	7.8	8.2	8.0	8.7	10.0
Ritja e eksporteve	%	-3.2	19.2	6.0	17.6	13.2	6.3	18.7	25.3
Importet	USD milion	-1076.4	-1331.6	-1485.4	-1783.5	-2176.7	-2476.7	-2915.6	-4021.0
Importet	% të PBB	-29.5	-32.8	-33.5	-31.3	-29.8	-30.3	-32.0	-37.1
Ritja e importeve	%	19.6	23.7	9.0	4.3	3.0	10.6	15.6	27.1
Transfertat	USD milion	526.8	516.2	628.4	869.9	1095.5	1221.5	1269.6	1423.0
Transfertat	% të PBB	14.5	12.7	14.2	15.3	15.0	14.9	13.9	13.1
Bilanci i llogarisë korente	USD milion	-171.9	-282.1	-401.8	-378.7	-355.4	-603.0	-671.0	-1217.2
Bilanci i llogarisë korente	% të PBB	-4.7	-6.9	-9.0	-6.6	-4.9	-7.4	-7.4	-11.2
Investimet e huaja direkte	USD milion	143	207.3	135	178	343.9	277.1	325.3	637.5
Investimet e huaja direkte	% të PBB	3.9	5.1	3.0	3.1	4.7	3.4	3.6	5.9
Ritja e IHD	%	261.8	44.9	-36.4	14.5	63.0	-21.7	15.3	80.6
Mjetet valutore neto	USD milion	500.5	626.7	707.4	919.0	1259.0	1317.7	1688.7	2038.8
Mjetet valutore neto	Muaj importe	4.0	4.2	4.1	4.3	4.7	4.1	4.5	4.1

Tabela 2. Te adhurat tatimore për Shqipërinë sipas viteve (% ndaj totalit)

	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Te Ardhurat Tatimore								
A) T. Direkte	17.8	19.4	22.3	23.9	24.3	24.9	24.0	23.8
Tatmi mbi Fitimin	6.2	7.0	7.9	7.9	8.8	9.4	9.7	8.4
Tatimi mbi te Ardhurat Personale	3.5	4.3	4.0	3.8	3.7	3.6	3.7	5.9
Taksa Nacionale dhe te tjera	5.8	5.3	7.1	7.5	6.6	6.0	5.7	5.8
Taksa lokale	1.0	1.4	1.7	3.0	3.0	4.0	3.7	2.8
Tatimi mbi Biznesin e vogel	1.3	1.4	1.6	1.8	2.2	1.9	1.1	0.9
B) Kontribute	15.3	15.5	16.6	17.2	18.0	17.7	17.1	16.7
Sigurimi Shoqeror	14.2	14.2	15.2	15.6	16.5	16.2	15.6	14.9
Sigurimi Shendetsor	1.2	1.2	1.4	1.5	1.5	1.5	1.6	1.8
C) T. Indirekte	46.6	43.6	44.5	45.9	47.6	47.4	48.5	50.2
Tatimi mbi vleren e Shtuar	29.2	28.3	29.8	30.3	31.5	31.6	32.4	34.9
Akcizat	7.0	6.6	6.0	7.3	8.6	9.1	10.0	11.4
Taksa Doganore	10.4	8.8	8.7	8.3	7.5	6.7	6.1	3.9

Tabela 3. Te ardhurat tatimore sipas vende (% PBB)

	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
EU27	:	:	:	:	:	:	41.2	40.6	40.5	40.4	40.8
EA13	41.4	42.2	42.6	42.4	42.9	42.6	41.7	41.2	41.2	40.9	41.2
EU25	41.1	41.7	41.9	41.9	42.3	42.1	41.2	40.6	40.6	40.5	40.9
EA12	41.4	42.2	42.6	42.4	42.9	42.6	41.7	41.2	41.2	40.9	41.2
Shqipëria*	17.3	12.4	13.2	17.7	17.7	19.9	19.6	20.7	20.9	22.1	22.5
Belgjika	45.9	46.5	47.0	47.6	47.6	47.3	47.4	47.5	47.1	47.4	47.7
Bullgaria	:	:	:	:	:	32.6	31.4	30.2	32.9	34.6	34.8
Cekia	36.2	34.7	35.0	33.4	34.1	33.9	34.0	34.8	35.8	36.8	36.3
Danimarka	49.8	50.1	49.9	50.3	50.9	50.2	49.3	48.7	48.7	49.9	51.2
Gjermania	41.3	42.3	42.2	42.4	43.2	43.3	41.4	41.0	41.1	40.2	40.2
Estonia	37.9	35.6	35.9	34.9	34.6	31.3	30.2	31.2	31.6	31.5	31.0
Irlanda	34.9	35.1	34.3	33.4	33.4	32.9	31.1	29.8	30.5	31.9	32.2
Greqia	34.7	35.1	36.4	38.4	39.6	40.0	38.7	38.9	37.8	36.7	36.7
Spanja	33.6	34.0	34.1	33.9	34.4	34.8	34.3	34.7	34.7	35.4	36.4
Franca	44.5	45.7	45.9	45.8	46.8	45.9	45.6	44.9	44.7	45.0	45.8
Italia	41.8	42.3	44.2	42.9	42.9	42.1	41.8	41.2	41.7	41.0	40.8
Qipro	26.9	26.8	26.0	28.2	28.5	30.5	31.5	31.5	33.3	34.1	36.2
Letonia	33.2	30.8	32.1	33.8	32.4	29.7	28.7	28.4	28.7	28.7	29.6
Lituania	28.6	27.9	31.0	32.0	31.9	30.2	28.7	28.4	28.2	28.6	29.2
Luksemburgu	38.2	38.6	40.4	40.4	39.2	40.0	40.6	40.0	39.4	38.8	39.1
Hungaria	41.7	40.6	39.0	39.1	39.2	38.6	39.0	38.6	38.5	38.7	38.6
Malta	31.0	26.0	28.3	26.4	28.1	29.2	31.5	33.1	33.2	36.2	37.7
Hollanda	41.4	41.4	40.8	40.6	41.5	40.9	39.4	38.7	38.4	38.7	39.2
Austria	43.6	44.8	46.2	46.2	45.8	44.8	46.5	45.5	44.8	44.4	43.6
Polonia	32.4	37.2	36.5	35.4	35.3	34.0	33.6	34.3	33.4	32.7	34.2
Portugalia	32.7	33.5	33.6	33.9	34.8	35.2	34.8	35.6	36.3	35.4	36.3

Rumania	:	:	:	:	:	:	27.8	28.6	28.1	27.8	28.8
Sllovenia	40.5	39.4	38.3	39.1	39.5	38.9	39.2	39.6	39.8	39.9	40.7
Sllovakia	39.7	38.1	35.1	35.7	34.3	33.0	31.6	32.0	31.1	30.0	29.5
Finlanda	46.3	47.6	46.8	46.5	46.1	47.4	44.7	44.7	44.1	43.7	44.0
Suedia	49.7	52.1	52.6	53.4	54.0	54.1	52.1	50.5	51.0	51.3	52.1
Britani e Madhe	36.9	36.5	37.1	38.0	38.4	38.9	38.7	37.3	37.1	37.4	38.6
Kroacia	42.3	42.8	42.5	42.5	42.8	43.0	43.2	43.6	42.9	44.0	45.0

Burimi: Eurostat, Mars 2007. MoF përShqiperine*: Per vitet 2006-2007, te ardhurat tatimore ndaj PBB kane arritur ne 23 dhe 23.3%.

Tabela 4. Te ardhurat tatimore sipas kategorive dhe vendeve (% te PBB)

	Taksa mbi prodhimin dhe importet (TVSH, Akcize, Takse Doganore)			Taksa mbi te ardhurat (Tatim fitimi, TAP, Tatim Biznesi i Vogel)			Kontributet e sigurimeve shoqerore		
	1995	2000	2005	1995	2000	2005	1995	2000	2005
EU27	:	:	13.8	:	:	12.8	:	:	13.0
EA13	13.1	13.9	13.8	11.1	12.7	11.7	15.7	14.7	14.4
EU25	13.4	14.1	13.8	12.2	13.8	12.9	14.1	13.1	13.0
EA12	13.1	13.9	13.7	11.1	12.7	11.7	15.7	14.7	14.4
Shqiperia	9.7	11.6	11.8	1.7	2.7	3.7	4.0	3.8	4.4
Belgjika	12.9	13.8	13.9	16.3	17.1	17.1	14.4	13.9	13.9
Bullgaria	:	15.1	19.0	:	7.0	6.1	:	11.0	10.5
Cekia	12.3	11.3	11.9	9.6	8.3	9.3	14.4	14.2	15.1
Danimarka	17.0	17.2	17.9	30.7	30.3	31.2	1.1	1.8	1.1
Germania	12.0	12.5	12.1	10.8	12.3	10.2	17.3	17.3	16.7
Estonia	13.9	12.4	13.5	10.9	7.8	7.1	13.1	11.0	10.4
Irlanda	14.5	13.7	13.6	13.5	13.3	12.3	5.0	4.4	4.8
Greqia	14.4	15.5	12.9	7.4	10.6	9.3	10.5	11.5	12.1

Spanja	10.7	11.9	12.5	9.9	10.2	10.9	11.8	12.0	12.2
Franca	16.1	15.8	15.8	8.1	12.0	11.4	18.6	16.1	16.4
Italia	12.4	15.2	14.5	14.5	14.4	13.3	12.7	12.1	12.6
Qipro	11.4	12.4	17.4	8.7	10.9	9.4	6.5	6.5	8.4
Latvia	14.1	12.3	12.9	7.1	7.3	8.0	12.0	9.9	8.5
Lituania	12.4	12.6	11.5	8.7	8.5	9.1	7.4	9.4	8.3
Luksemburgu	11.8	14.0	13.4	15.3	14.9	14.0	9.9	10.1	10.8
Hungaria	17.8	16.1	15.8	8.8	9.5	9.0	14.9	12.9	13.6
Malta	12.2	12.6	16.7	8.0	9.1	11.8	6.0	6.4	7.2
Hollanda	11.8	12.5	13.1	12.3	11.6	11.6	15.9	15.4	13.1
Austria	14.8	15.1	14.7	11.6	13.1	12.9	14.9	14.7	14.6
Polonia	14.2	12.6	13.9	11.7	7.2	7.0	11.3	14.4	13.7
Portugalia	13.9	14.1	15.1	8.4	9.8	8.7	9.6	10.3	11.3
Rumania	:	:	13.0	:	:	5.3	:	:	9.7
Sllovenia	15.9	16.3	16.4	7.1	7.5	9.3	17.3	14.7	14.8
Sllovakia	15.1	12.8	13.0	11.5	7.6	6.1	14.1	13.6	10.9
Finlanda	14.2	13.9	14.1	17.3	21.1	17.5	14.5	12.1	12.1
Suedia	16.1	16.8	17.3	19.9	22.2	20.1	13.0	14.4	13.9
Anglia	14.1	14.2	13.3	15.1	16.8	16.5	6.8	6.9	8.0
Kroacia	16.1	13.7	12.9	16.2	20.2	23.1	9.9	9.0	9.1

Burimi: Eurostat, Mars 2007. Per Shqiperine te dhenat jane te Ministrise se Financave

Tabela 5. Normat e tatim fitimit sipas vende.

Vendet/Shkalla	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Shqipëria	30	30	30	30	25	23	20	20	10
Austria	34	34	34	34	34	25	25	25	
Kroacia		20	20	20.3	20.3	20.3	20.3		
Rumani	38	25	25	25	25	16	16	16	16
Serbia				14	14	14	10	10	
Mali I zi							9	9	9
Bullgaria						15	15	10	10
Maqedonia							15	12	10
Rep. Ceke	31	31	31	31	28	26	24	24	21
Estonia						24	23	22	22
France	36.66	35.3	34.33	34.33	34.33	33.83	33.33	33.33	33.33
Gjermani	51.6	38.36	38.36	39.58	38.29	38.31	38.34	30-33	30-33
Greqi	40	37.5	35	35	35	32	29	22/25	22/25
Hungari	18	18	18	18	16	16	16	16	16
Italia	41.25	40.25	40.25	38.25	37.25	37.25	37.25	31.4	31.4
Spanja	35	35	35	35	35	35	35	32.5	32.5
Turqia	49.22	42.8	44	44	44	44	33	20	20

Burimi: KPMG, 2007

Tabela 6. Kontributet e sigurimit shoqëror sipas vendeve.

Vendi	Total %	Punedhësi %	Punëmarresi %
Shqipëria	29.5	20	9.5
Rumani	47	30	17
Bullgari*	42	29.55	12.45
Greqi*	34.06	28.06	16
Letoni	33.09	24.09	9
Rep. Ceke	47.5	35	12.5
Hungari	41.5	29	12.5
Itali	39-46	30-37	9
Serbi*	71.6	35.8	35.8
Kroaci	37.2	Shtylla e pare: 20 Shtylla e dyte: 5	
Slovaki*	48.6	35.2	13.4
Portugali*	34.75	23.75	11
Maqedoni	21.2		
Mali I Zi	36.1	20	16.1
Sloveni	38.2	16.1	22.1
Gjermani	25.8	12.9	12.9
Qipro	12.6	6.3	6.3
Turqi	33.4	19.5	14
Luksemburg	16	8	8

*: *Jane te përfshira edhe kontributet e sigurimeve shëndetësore*

Tabela 7. Treguesit kryesorë makroekonomike : 2008-2013

Treguesit	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Popullsia	3,173,825	3,184,697	3,194,538	3,205,894	3,217,290	3,228,726
Inflacioni mesatar vjetor	3.5	3.2	3.0	3.0	3.0	3.0
Deflatori i GDP-se	3.3	3.3	2.5	2.7	2.8	3.0
Kursi i këmbimit valutor (<i>lekë/usd</i>)	89.0	90.0	92.0	92.0	93.0	93.0
Kursi i këmbimit valutor (<i>lekë/euro</i>)	122	123	123	122	122	122
PBB nominal (<i>në milion lekë</i>)	1,073,000	1,178,000	1,291,000	1,419,000	1,563,000	1,723,000
Rritja reale e PBB (<i>në %</i>)	6.1	6.3	6.9	7.0	7.1	7.0
PBB nominal për banore (<i>në lekë</i>)	338,078	369,894	404,127	442,622	485,813	533,647
PBB nominal për banore (<i>në usd</i>)	3,799	4,110	4,393	4,811	5,224	5,738
Investimet totale (<i>në % të PBB</i>)	31.2	30.2	32.3	32.0	31.8	29.1
<i>publike</i>	9.3	7.0	6.9	6.6	6.6	6.5
<i>private</i>	21.9	23.2	25.4	25.4	25.2	22.6
Të ardhurat totale (% të PBB)	28.2	28.2	28.5	28.6	28.7	28.7
<i>Nga tatimet dhe dogana (% të PBB)</i>	19.5	19.6	19.6	19.7	19.8	19.8
Shpenzimet totale (% të PBB)	33.4	32.1	32.0	31.8	31.8	31.6
Bilanci (% të PBB)	-5.2	-3.9	-3.5	-3.2	-3.1	-3.0
Huamarrja e brendshme (% të PBB)	0.4	2.3	2.2	2.1	2.0	2.0
Privatizimi (% të PBB)	0.9	0.1	0.1	0.0	0.1	0.1
Huamarrja e jashtme neto (% të PBB)	4.0	1.5	1.2	1.1	1.0	0.9
Borxhi Publik (% të PBB)	53.8	52.8	51.6	50.1	48.6	46.9
<i>I Brendshëm (% të PBB)</i>	34.8	34.0	33.2	32.3	31.4	30.4
<i>I Huaj (% të PBB)</i>	19.0	18.8	18.4	17.8	17.2	16.5
Kursimet private (<i>në % të PBB</i>)	22.0	22.8	23.2	23.9	23.7	24.1
Kredia për sektorin privat (<i>në % të PBB</i>)	28.8	31.3	33.1	34.7	36.0	37.1
Paraja e gjerë (<i>në % të PBB</i>)	80.1	82.2	82.8	83.0	83.2	83.8
Bilanci tregtar (<i>në % të PBB</i>)	-25.8	-21.4	-20.6	-20.1	-19.2	-18.9
Bilanci i llogarisë korente (<i>në % të PBB</i>)	-8.9	-7.2	-5.8	-5.4	-5.2	-5.0
Bilanci i pagesave (<i>në milion euro</i>)	0.7	1.1	1.4	1.9	1.8	2.1

Tabela 8. Treguesit fiskal: 2008-2013*

	Si përqindje e PBB-së (%)						Në miliardë lekë					
	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2008*	2009	2010	2011	2012	2013
<i>Të ardhurat</i>												
Nga tatimet dhe dogana	19.5	19.6	19.6	19.7	19.8	19.8	209,711	230,888	253,036	278,834	308,693	340,293
Pushteti vendor	1.5	1.6	1.6	1.7	1.7	1.7	15,582	18,848	20,656	24,123	26,571	29,291
Sigurimet shoqërore	4.8	5.1	5.3	5.3	5.3	5.3	51,059	60,078	68,423	75,207	82,839	91,319
Jotatimore	2.0	1.5	1.5	1.4	1.4	1.4	21,601	17,810	18,999	20,000	21,882	24,122
Grantet	0.4	0.4	0.5	0.5	0.5	0.5	4,733	4,712	6,455	7,095	7,815	8,615
Gjithsej	28.2	28.2	28.5	28.6	28.7	28.7	302,686	332,336	367,569	405,259	447,800	493,640
<i>Shpenzimet</i>												
Personeli	6.3	6.3	6.3	6.3	6.3	6.2	67,957	73,710	81,343	89,397	97,745	106,826
Operative dhe mirembajtje	2.6	2.8	2.9	3.1	3.1	3.1	27,671	32,984	37,377	43,731	48,572	53,413
Interesa	3.1	3.1	3.0	2.9	2.9	2.9	33,000	36,356	38,481	41,100	45,534	49,967
Subvencione	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	2,276	2,785	2,868	2,900	3,173	3,446
Sociale	8.5	8.7	8.7	8.7	8.7	8.7	91,445	102,486	112,317	123,453	135,981	149,901
Të tjera	3.4	4.0	4.0	4.0	4.0	4.0	36,666	47,120	51,640	56,760	62,675	68,920
Kapitale	9.3	7.0	6.9	6.6	6.6	6.5	99,520	82,460	89,079	93,654	103,158	111,995
Gjithsej	33.4	32.1	32.0	31.8	31.8	31.6	358,534	377,900	413,105	450,995	496,838	544,468
Bilanci	-5.2	-3.9	-3.5	-3.2	-3.1	-3.0	- 55,848	- 45,564	- 45,536	- 45,736	- 49,038	- 50,829
<i>Financimi</i>												
Privatizimi	0.9	0.1	0.1	0.0	0.1	0.1	9,140	1,000	1,000	500	1,138	1,723
Huamarrja e brendshme	0.4	2.3	2.2	2.1	2.0	2.0	3,780	27,252	28,412	30,016	31,741	33,599
Huamarrja e jashtme neto	4.0	1.5	1.2	1.1	1.0	0.9	42,929	17,312	16,124	15,221	16,159	15,507